



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA | REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE
AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION



RAPORT VJETOR

JANAR – DHJETOR 2024

Mars 2025

AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT (APK)**RAPORT VJETOR****JANAR – DHJETOR 2024**

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK), si organ i pavarur dhe i specializuar për zbatimin e politikave shtetërore për parandalimin e korrupsionit në Kosovë, sipas Nenit 15 të Ligjit Nr. 08/L017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, paraqet Raportin vjetor të punës për periudhën 01 janar-31 dhjetor 2024 në Kuvendin e Republikës së Kosovës, përkatësisht në Komisionin Parlamentar për Legjislacion, Mandate dhe Mbikëqyrje të Agjencisë kundër Korrupsionit.

Raporti vjetor i Agjencisë për vitin 2024, pasqyron punën e Agjencisë përgjatë një viti, si dhe një analizë të veprimtarisë së Agjencisë lidhur me realizimin e aktiviteteve të bazuara në planin e performancës së vitit 2024, krahasime me vitet e kaluara dhe analiza lidhur me veprimet e parandalimit të korrupsionit që ka të bëjë me zbatimin e kornizës ligjore kundër korrupsionit.

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	4
LISTA E SHKURTESAVE.....	5
PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I AGJENCISË, KORNIZA LIGJORE DHE ORGANIZIMI I BRENDSHËM, BUXHETI, PERSONELI DHE PROKURIMI	6
KORNIZA LIGJORE	6
BUXHETI	8
ADRESIMI I REKOMANDIMEVE TË ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT (ZKA)	10
PERSONELI	11
PROKURIMI	11
MENAXHIMI I SISTEMEVE TË TEKNOLOGJISË INFORMATIVE DHE E-SHËRBIMET	11
DEKLARIMI I PASURISË	14
TRAJTIMI I RASTEVE TË SINJALIZIMIT.....	15
ZBATIMI I LEGJSLACIONIT KUNDËR KORRUPSIONIT, SI DHE PLOTËSIMI DHE NDRYSHIMI I TIJ	16
RASTET E REFERUARA NGA AGJENCIA NË AUTORITETET E ZBATIMIT TË LIGJIT (PROKURORI DHE GJYKATA) ...	17
INFORMATA STATISTIKORE PËR VENDIMET NË LIDHJE ME RASTET E REFERUARA NGA AGJENCIA	17
PËRFAQËSIMI I RASTEVE NË GJYKATA	19
PARANDALIMI I KONFLIKTIT TË INTERESIT NË USHTRIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE.....	19
DEKLARIMI SIPAS LLOJEVE.....	24
KONTROLLI I PASURISË	26
DEKLARIMI I DHURATAVE TË PRANUARA NGA INSTITUCIONET	28
VLERËSIMI I RREZIKUT DHE I AKTEVE LIGJORE KUNDËR KORRUPSION.....	31
BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET VENDORE	37
BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE DHE INSTITUCIONE TË HUAJA	39
BASHKËPUNIMI RAJONAL.....	41
AKTIVITETET MEDIATIKE	41
AKTIVITETET E VETËDIJËSIMIT TË PUBLIKUT	42
KËRKESAT PËR QASJE NË INFORMATA PUBLIKE.....	42
JAVA E INTEGRITETIT 2024.....	43
TRAJTIMI I RASTEVE TË SINJALIZIMIT TË JASHTËM.....	47
TRAJTIMI I RASTEVE TË SINJALIZIMIT TË BRENDSHËM.....	48
MËSIMET E NXJERRA DHE PRIORITETET NË TË ARDHMEN	50
SHTOJCA NR.2. LISTA E PJESËMARRJES NË TRAJNIME, FORUME, SEMINARE GJATË VITIT 2024	54

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti vjetor i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit për vitin 2024 përmbledh veprimet lidhur me përpjekjet dhe arritjet në luftën kundër korrupsionit në të gjitha fushat e veprimtarisë së saj. Këto janë disa nga elementet kyçe të raportit:

Fokusimi në Parandalimin e Korrupsionit: Agjencia ka përqendruar punën dhe aktivitetet e saj në parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit. Kjo përfshin mbrojtjen e sinjalizuesve, organizimin e procesit të deklarimit të pasurisë, si dhe pranimit të dhuratave gjatë kryerjes së detyrës zyrtare.

Shqyrtimi i Kërkesave dhe Informacioneve: Agjencia ka shqyrtuar dhe trajtuar në mënyrë të vazhdueshme kërkesa dhe informacione të adresuara nga institucionet publike, raportime anonime, si dhe kërkesa nga media dhe shoqëria civile.

Përkrahja Profesionale për Institucionet: Agjencia ka ofruar përkrahje dhe ekspertizë profesionale në hartimin e rregullave të brendshme për parandalimin e korrupsionit sipas kërkesave dhe nevojave të institucioneve publike, e atë kryesisht në lidhje me planet e integritetit dhe çështjet e etikës.

Pasqyrimi i Punës së Agjencisë: Raporti përmban një pasqyrë të përgjithshme të punës së kryer gjatë vitit 2024, duke përfshirë aktivitetet dhe programet e trajnimit për ngritjen e vetëdijes në lidhje me parandalimin e korrupsionit, duke përfshirë realizimin e produkteve vizive dhe pranimin e trajtimit e mbi 11,000 regjistrave të deklarimit të pasurisë.

Zbatimi i Legjislacionit dhe Plotësimi i tij: Raporti përshkruan reformat në legjislacion dhe zbatimin e tyre, të cilat kanë ndikuar në forcimin e procedurave të brendshme të operimit dhe kontrollit për parandalimin e korrupsionit, duke përfshirë hartimin dhe aprovimin e akteve nënligjore.

Bashkëpunimi Ndërkombëtar: Adresimi i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe rajonal, duke përfshirë takime, anëtarësime, vizita studimore, trajnime, dhe shkëmbim informacioni me organizata dhe institucione të tjera ndërkombëtare.

Sfidat dhe Prioritetet për të Ardhmen: Raporti identifikon sfidat me të cilat është përballur Agjencia gjatë vitit 2024 dhe prezanton planet dhe prioritetet për të ardhmen në luftën kundër korrupsionit.

Këto elemente paraqesin një pasqyrë të përgjithshme të përpjekjeve të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit gjatë vitit 2024 dhe sfidat për të ardhmen në këtë fushë.

LISTA E SHKURTESAVE

APK	Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit
ARBK	Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës
ARC	Agjencia për Regjistrim Civil
GJK	Gjykata Kushtetuese
GJTH	Gjykata Themelore
IKAP	Instituti Kosovar për Administratë Publike
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
KPPK	Kodi i Procedurës Penale të Kosovës
KQZ	Komisioni Qendror Zgjedhor
KRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
LDC	Leadership and Development Consultancy
MAP	Ministria e Administratës Publike
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MD	Ministria e Drejtësisë
MDA	Management Development Association
MFT	Ministria e Financave dhe Transfereve
MFSK	Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
NJPMNP	Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
OE	Operator Ekonomik
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë
OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
PSRK	Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
PSH	Prokuroria e Shtetit PTH Prokuroria Themelore
QKSPEZH	Qendra e Kosovës për Siguri Publike Edukim dhe Zhvillim
RAI	Regional Anti- Corruption Initiative
SPV	Strategjia dhe Plani i Veprimit Agjencisë kundër Korrupsionit
TI	Transparency International
UNDP	United Nations Development Program
UP	Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”
ZKM	Zyra e Kryeministrit

PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I AGJENCISË, KORNIZA LIGJORE DHE ORGANIZIMI I BRENDSHËM, BUXHETI, PERSONELI DHE PROKURIMI

KORNIZA LIGJORE

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit është organ i pavarur dhe i specializuar për zbatimin e politikave shtetërore, për parandalimin e korrupsionit në Kosovë. Ligji Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, përcakton statusin dhe kompetencat e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit lidhur me shqiptimin e masave dhe sanksioneve, me synim parandalimin e korrupsionit, forcimin e integritetit dhe transparencës institucionale në Republikën e Kosovës, si dhe monitorimin e zbatimit të strategjisë shtetërore.

Përgjegjësitë e Agjencisë sipas Ligjit Nr. 08/L-017 janë si në vijim:

- Zbatimin e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave dhe Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve që përfshijnë: Mbikëqyrjen dhe parandalimin e rasteve të konfliktit të interesit dhe marrjen e masave të parapara me ligjin e veçantë; Mbikëqyrjen e deklarimit të pasurive; dhe Mbikëqyrjen e pranimit të dhuratave që lidhen me kryerjen e detyrës zyrtare dhe ndërmarrjen e masave të parapara me ligj;
- Dhënien e mendimeve lidhur me konfliktin e interesit dhe mbikëqyrjen e dhuratave që lidhen me kryerjen e detyrës zyrtare;
- Mbikëqyrjen dhe marrjen e masave të nevojshme për mbrojtjen e sinjalizuesve.
- Ndërmarrjen e veprimeve në fushën e monitorimit të planit të veprimit të strategjisë nacionale kundër korrupsionit, vlerësimit kundër- korrupsion të akteve ligjore, vlerësimeve të rrezikut të korrupsionit dhe planeve të integritetit që përfshijnë:
- Dhënien e ndihmës profesionale dhe teknike, këshilla dhe mbështetje të iniciativave të cilat synohen të ndërmerren nga institucionet për parandalim të korrupsionit;
- Dhënien e rekomandimeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës mbi vlerësimin e projektligjeve që lidhen me parandalimin e korrupsionit kur kjo kërkohet nga këto institucione apo me vendim të Drejtorit të Agjencisë;
- Monitorimin e zbatimit të Strategjisë Kundër Korrupsionit dhe planit të saj të veprimit;
- Bashkëpunimin me institucionet shtetërore dhe shoqërinë civile për vetëdijesimin e publikut për parandalimin e korrupsionit;
- Zhvillimin dhe mbikëqyrjen e vlerësimit të rrezikut të korrupsionit dhe Dhënien e opinionëve lidhur me aktet ligjore për qëllim të përafrimit me standardet ndërkombëtare kundër korrupsionit;
- Monitorimin e zbatimit të planit të integritetit të institucioneve publike;
- Kryerjen e hetimeve administrative dhe ndërmarrjen e veprimeve në rastet që bien në kuadër të kompetencave të Agjencisë; Referimin e kallëzimeve penale në prokurorinë e shtetit ose në rast të shkeljes administrative përcjelljen e rastit tek organi administrativ kompetent
- Inicimin e procedurave kundërvajtësve nga fushë veprimtaria e vet në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi dhe Shqiptimi i gjobave dhe ndërmarrjen e masave tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi.

ORGANIZIMI I BRENDSHËM

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit gjatë vitit 2024 ka funksionuar mbi bazën e Rregullores Nr. 01/2023 për Organizimin dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në APK, të zëvendësuar pastaj me Rregulloren Nr. 07/2024 për Organizimin dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në APK, të miratuar konform Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, sipas strukturës së re të brendshme organizative ([Organogrami i Agjencisë](#)).

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit në vitin 2024 ka funksionuar me 43 të punësuar/zyrtarë sipas strukturës së re organizative të ndara në departamente, divizione dhe njësi.

- Departamenti për Vlerësim, Monitorim dhe Analiza, i cili është përgjegjës për vlerësimin e legjislacionit në përputhje me parimet dhe standardet vendore dhe ndërkombëtare kundër korrupsionit, si dhe të sigurojë monitorim efektiv dhe analizim pro aktiv të zbatimit të planeve të integritetit dhe strategjisë shtetërore kundër korrupsionit. Ky Departament është përbërë nga: 1. Divizioni Vlerësim dhe Analiza kundër Korrupsionit, dhe 2. Divizioni për Integritet dhe Strategji.
- Departamenti për Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave, i cili është përgjegjës për sigurimin e një sistemi efektiv të deklarimit dhe të kontrollit të pasurisë së deklaruar, si dhe të deklarimit dhe inspektimit të dhuratave. Ky Departament është i përbërë nga: 1. Divizioni për Kontrollin dhe Verifikimin e Pasurisë, dhe 2. Divizioni për Inspektimin dhe Auditimin e Dhuratave.
- Departamenti për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, i cili është përgjegjës për forcimin e integritetit të sektorit publik dhe garantimin e kryerjes së detyrave publike në mënyrë objektive, të paanshme dhe transparente në shërbim të interesit publik nëpërmjet identifikimit, parandalimit, menaxhimit dhe zgjidhjes së konfliktit të interesave të zyrtarëve. Ky Departament është i përbërë nga: 1. Divizioni për Zgjidhjen e Konfliktit të Interesit dhe 2. Divizioni për Këshillim dhe Raportim.
- Departamenti për Administratë dhe Shërbime të Përgjithshme, i cili është përgjegjës për sigurimin e njësive organizative të Agjencisë të kenë shërbime dhe mbështetje administrative efikase, e-shërbime dhe teknologji informative në mënyrë efektive. Ky Departament është i përbërë nga: 1. Divizioni për Shërbime të Përgjithshme, dhe 2. Divizioni për E-shërbime dhe Sisteme.
- Divizioni për Buxhet dhe Financa, i cili është përgjegjës për zhvillimin e politikave, legjislacionit, dokumenteve strategjike dhe udhëzimeve në fushën e menaxhimit financiar, procedurave dhe dokumenteve lidhur me buxhetin dhe shpenzimet buxhetore, përgatitjen, menaxhimin e buxhetit dhe mbikëqyrjen e shpenzimeve financiare për të gjitha njësitë organizative të Agjencisë.
- Divizioni për Sinjalizim, i cili është përgjegjës për sigurimin e funksionimit efikas të mekanizmave të sinjalizimit të shkeljeve në sektorin publik, hetimin administrativ dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.

- Divizioni për Përfaqësim, Standardizim dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare, i cili është përgjegjës për sigurimin e përfaqësimit ligjor adekuat, zbatimin efektiv të standardeve profesionale, si dhe avancimit të bashkëpunimit ndërkombëtar.
- Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, e cila është përgjegjëse për sigurimin e menaxhimit efektiv të burimeve njerëzore, përmes zhvillimit të procedurave dhe shërbimeve të cilat kontribuojnë në arritjen e qëllimeve të institucionit dhe punonjësve.
- Zyrtari i Prokurimit, i cili është përgjegjës për zhvillimin e procedurave dhe aktiviteteve të prokurimit sipas Ligjit për Prokurimin Publik.
- Zyrtari për Informim dhe Edukim, i cili është përgjegjës në organizimin, koordinimin, drejtimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve lidhur me edukimin dhe informimin e publikut dhe mediave përkitazi me punën, aktivitetet dhe veprimtarinë e Agjencisë.

BUXHETI

Sipas Ligjit për Agjencinë: APK harton buxhetin vjetor në pajtueshmëri me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike, si dhe vendos në mënyrë të pavarur për përdorimin e buxhetit, në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

Me Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore, Buxheti i Agjencisë për vitin 2024 ka qenë 965,660.00 €. Buxheti final në fund të vitit 2024 ka qenë 782,473.18€. Nga buxheti final janë shpenzuar në total prej 760,842.43 €, shprehur në përqindje 97.25%.

Mjetet e ndara janë planifikuar dhe janë menaxhuar sipas obligimeve ligjore të përcaktuara me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike, të cilat i kanë përmbushur nevojat reale të institucionit.

Sipas kërkesës në fund të vitit 2024 nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, përkatësisht nga Departamenti i Buxhetit, për evidentimin e kursimeve të mundshme buxhetore, Agjencia ka evidentuar kursimet e mundshme buxhetore sipas kërkesës në kategoritë: Paga dhe shtesa, Mallra dhe shërbime, Shërbime Komunale dhe Investime Kapitale, të cilat kursime nuk janë reflektuar në buxhetin përfundimtar përveç në kategorinë Paga dhe Shtesa me vendim të Qeverisë.

Agjencia gjatë vitit 2024 ka filluar me pranimin e të hyrave nga procesi i shqiptimit të gjobave për subjektet deklaruese, në rastet siç është e përcaktuar me Ligj. Totali i të hyrave jo tatimore është 9,887.99€.

	Kategoritë ekonomike	Buxheti i aprovuar (fillestar)	Buxheti final Pas rishikimit	Shpenzimet në total	% e realizimit bazuar në buxhetin final
Nr.		a	b	c	d=(c÷b)
1	Paga dhe Shtesa	739,694.00	556,507.18	556,507.18	100%
2	Mallra dhe Shërbime	123,466.00	123,466.00	112,697.66	91.27%
3	Shpenzime Komunale	8,500.00	8,500.00	3,120.09	36.70%

4	Pasurit jo financiare	94,000.00	94,000.00	88,760.84	94.16%
5	Totali	965,660.00	782,473.18	760,842.43	97,23%
	Pranimet- Të hyrat	9,887.99			

Tabela Nr. 1 pasqyron buxhetin fillestar sipas kategorive ekonomike, buxhetin final, shpenzimet, përqindja(%) e realizimit dhe të hyrat

Bazuar në ndarjet buxhetore, pas alokimit të fondeve konform planifikimeve dhe obligimeve kontraktuale, planit të prokurimit si dhe aktiviteteve të brendshme të institucionit është përgatitur plani i rrjedhjes së parasë.

Paga dhe Shtesa - Ndarjet fillestare në kategorinë e Paga dhe Shtesa kanë qenë 739,694.00 €, ndërsa buxheti final ka qenë 556,507.18 mjete të shpenzuara në vlerën 556,507.18 €, shprehur në përqindje 100%. Dallimi në mes të buxhetit fillestar dhe atij final është për arsye se Agjencisë me buxhetin e vitit 2024 i janë aprovuar 15 pozita të reja. Me aprovimin e Rregullores Nr. 07/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, sipas parashikimit të pozitave të punës me strukturën e re janë shpallur edhe pozitat e reja të rekrutimit sipas nevojave të ngritjes së kapaciteteve të Agjencisë, proces ky i cili ka vazhduar gjatë gjithë vitit.

Mallra dhe Shërbime- Buxheti i ndarë në kategorinë Mallra dhe Shërbime ka qenë 123,466.00€. Nuk ka pasur ndryshime të buxhetit final nga ai fillestar, ndërsa janë shpenzuar 112,697.66€, që i bie se përqindja e realizimit të buxhetit ka qenë në masën 91.27%. Të gjitha shpenzimet e realizuar nga kjo kategori kanë mbuluar nevojat për furnizime dhe shërbime të ndryshme të Agjencisë. Sipas kërkesës së MFTP për evidentimin e kursimeve të mundshme, Agjencia ka deklaruar si kursime shumë prej 6,000.00€, mirëpo kjo nuk është reflektuar në buxhetin final.

Shpenzimet Komunale -Buxheti i ndarë në kategorinë e Shpenzimeve Komunale ka qenë 8,500.00€, ndërsa janë shpenzuar 3,120.09€, shprehur në përqindje 36.70%. Tek kjo kategori Agjencia ka bërë pagesën e telefonisë fikse pasi që obligimet e tjera që rrjedhin nga kjo kategori janë të mbuluara nga ana e MPB.

Sipas kërkesës së MFPT për evidentimin e kursimeve në kategorinë e Shërbimeve Komunale, Agjencia ka deklaruar shumë prej 5,000.00€ si mjete të lira, mirëpo kjo nuk është reflektuar në buxhetin final.

Investime Kapitale – Buxheti i ndarë në kategorinë e Investimeve Kapitale për vitin 2024, ka qenë 94,000.00€ për projekt **Rregullimin e ServerRoom-it të Agjencisë dhe Zhvillimi Harduerik dhe softuerik**, për të cilin projekt janë shpenzuar 88,517.50€ shprehur në përqindje 94.16%. Ky projekt është realizuar në tërësi gjatë vitit.

Sipas kërkesës së MFPT për evidentimin e kursimeve në kategorinë për Investime Kapitale, Agjencia ka deklaruar shumë prej 5,000.00€, mirëpo kjo nuk është reflektuar në buxhetin final.

Të Hyrat - Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit nga procesi i shqiptimit të gjobave, gjatë vitit 2024 ka realizuar të hyra në vlerë prej 9,887.99€.

Nr.	Kategoritë ekonomike	Buxheti final për vitin 2024	Shpenzimet 2024	Buxheti final për vitin 2023	Shpenzimet 2023	Buxheti final për vitin 2022	Shpenzimet 2022
		a	b	c	d	e	f
1	Paga dhe Shtesa	556,507.18	556,507.18	513,851.18	513,851.18	413,222.00	413,201.12
2	Mallra dhe Shërbime	123,466.00	112,697.66	114,056.00	101,110.04	114,056.00	112,242.13
3	Shpenzime Komunale	8,500.00	3,120.09	8,500.00	2,703.01	3,500.00	3,196.47
4	Pasuritë jo financiare	94,000.00	88,517.50	20,000.00	6,677.00	8,216.00	7,273.92
	Totali	782,473.18	760,842.43	656,407.18	624,341.23	538,994.00	535,913.64

Tabela Nr.2 pasqyron ndarjen ndarjen buxhetore sipas kategorive ekonomike dhe shpenzimeve për periudhën 2022-2024

ADRESIMI I REKOMANDIMEVE TË ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT (ZKA)

Me rastin e kontrollit financiar për vitin 2023, vlerësimi i përgjithshëm për pasqyrat financiare në të gjitha aspektet materiale kanë pasur prezantim të drejtë dhe të vërtetë. Në Raportin e Auditimit për PVF të APK-së, kanë qenë tri rekomandime, të cilat janë përmbushur në tërësi.

Rekomandimi 1- lidhur me sigurimin e zotimit të mjeteve dhe nxjerrjes së urdhër blerjeve para pranimit të mallrave dhe faturave, me qëllim të respektimit të procedurave dhe evitimit të rritjes së detyrimeve të papaguara.

Sipas rekomandimeve, zyrtarët përgjegjës janë angazhuar që të respektohen procedurat ligjore që mos të ketë raste kur fatura pranohet para zotimit të mjeteve dhe nxjerrjes së urdhër blerjes.

Rekomandimi 2- lidhur me forcimin e kontrollit në fushën e financave, me qëllim të sigurimit të të gjitha obligimeve, pagesës brenda afatit ligjor prej 30 ditësh pas pranimit të faturave.

Agjencia çdo muaj përgatit raportin e obligimeve të pa paguara dhe raporton në Thesar. Rastet kur fatura ka kaluar 30 ditë kanë qenë raste të veçanta dhe të arsyeshme, pasi përkushtimi i zyrtarëve përgjegjës është që të gjitha pagesat të realizohen me kohë brenda afateve.

Rekomandimi 3- Sigurimin e regjistrimit të të gjitha pasurive në regjistrat përkatës të pasurive të organizatës buxhetore.

Agjencia ka ndërmarr veprimet sipas rekomandimeve dhe ka bërë regjistrimin e Pasurisë në regjistrat kontabël.

Ndërsa tani jemi në proces të auditimit nga ZKA dhe ende nuk kemi pranuar raportin e auditimit për vitin 2024.

PERSONELI

Agjencia ka të punësuar 43 zyrtarë, prej të cilëve 3 zyrtarë janë në pushim pa pagesë, pozita të pezulluara konform Ligjit Nr. 08/L-179 për Zyrtarët Publik. Në kuadër të planit të rekrutimit janë zhvilluar disa procedura të rekrutimit dhe janë zgjedhur pozitat: 1 pozitë nivel i mesëm drejtues, 4 pozita nivel i ulët drejtues, 5 pozita profesional 1, si dhe 4 pozita profesional 2.

Janë anuluar 2 pozita profesional 1 si dhe ka dështuar një pozitë profesional 1.

Bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë e menaxhimit të burimeve njerëzore është zbatuar dhe monitoruar plani për ngritjen e kapaciteteve profesionale të zyrtarëve të Agjencisë. Njësia e Menaxhimit të Burimeve njerëzore ka menaxhuar të gjitha sistemet që lidhen direkt me përgjegjësit e NJMBNJ-së, si sistemi për menaxhimin e Burimeve Njerëzore <https://hrmis.rks-gov.net/>, sistemi i Hyrje Daljeve <https://svp.rks-gov.net>, sistemi i Arkivave <https://smaed-online.rks-gov.net/>, si dhe sistemi i Menaxhimit të Pagave <https://smp.rks-gov.net/>. Janë bërë përditësimet e të dhënave të nevojshme për të gjitha këto sisteme, si përditësimi i të dhënave në dosjet e zyrtarëve, të gjitha ndryshimet që lidhen me pagat e zyrtarëve të APK-së, menaxhimi i pushimeve si dhe raportet mujore për ditët e vijueshmërisë në punë për të gjithë zyrtarët.

Agjencia sipas Rregullores nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, ka miratuar Rregulloren Nr. 07/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në APK. Si rrjedhojë e kësaj janë klasifikuar pozitat duke transferuar zyrtarët në pozita të caktuara dhe për zbatimin e kësaj rregulloreje janë ndryshuar të gjitha Aktet e Emërimit.

(Shtojca nr.3, Lista e pjesëmarrjes në trajnime, forume, seminare brenda dhe jashtë vendit gjatë vitit 2024)

PROKURIMI

Bazuar në Planin e Prokurimit për vitin 2024, nga 16 aktivitete të planifikuara të prokurimit janë realizuar 14 aktivitete, ndërsa për 4 aktivitete nuk janë iniciuar procedurat e prokurimit. Në kuadër të aktiviteteve të prokurimit janë parashtruar kërkesat për iniciimin e aktiviteteve të prokurimit pranë AQP-së, nxjerrja e urdhër blerjeve në SIMFK, si dhe menaxhimi i kontratave. Po ashtu gjatë vitit 2024, pranë AQP-së janë parashtruar edhe 4 kërkesa për iniciimin e aktiviteteve të prokurimit, të cilat nuk kanë qenë të përfshira në Planin e Prokurimit, duke cekur edhe arsyet pse nuk kanë qenë të përfshira në Planin e Prokurimit të vitit 2024. Nga këto, 3 aktivitete të prokurimit janë realizuar ndërsa një 1 është anuluar.

MENAXHIMI I SISTEMEVE TË TEKNOLOGJISË INFORMATIVE DHE E-SHËRBIMET

Gjatë vitit 2024, për periudhën raportuese, është bërë transformim digjital në proceset kyçe të punës së Agjencisë. Përderisa në vitin 2023 për herë të parë kemi realizuar deklarin elektronik të pasurisë përmes platformës e-deklarimi, e cila është pjesë e sistemit elektronik të Agjencisë, DMSA (Data Management System of Agency), në vitin 2024 është vënë në funksion platforma për raportimin online të rasteve të dyshuara për keqpërdorim, platforma "RAPORTO KEQPËRDORIMIN".

Platforma Raporto Keqpërdorimin <https://raporto.rks-gov.net>, është zhvilluar gjatë vitit raportues dhe është implementuar dhe hostuar në dhjetor të vitit 2024. Kjo platformë, është realizuar me përkrahje financiare të projektit SAEK III, UNDP Seul. Me synimin e Agjencisë, për Kosovën pa Korrupsion kemi zhvilluar këtë platformë, e cila është bazuar në një platformë të ngjashme në Koren e Jugut, "Clean Portal", por e kemi adoptuar sipas mandatit të Agjencisë. Platforma Raporto Keqpërdorimin përbëhet nga dy pjesë kryesore, ueb portali për raportim të keqpërdorimeve nga qytetarët, dhe nga pjesa e menaxhimit të rasteve, ku të gjitha rastet e raportuara do të trajtohen në mënyrë elektronike, dhe raportuesi do të jetë i informuar për procesin e rastit të tij në kohë reale përmes platformës. Portali i raportimit të kësaj platforme përkrah raportimin e rasteve të dyshuara në tre gjuhë, shqip, serbisht dhe anglisht, dhe raportimin në te mund ta bëni për këto lloje të rasteve:

- Sinjalizim, mundëson raportimin e rasteve të sinjalizuesve;
- Konflikt i interesit, mundëson raportimin e rasteve të dyshuara për konflikt të interesit;
- Deklarim i pasurisë\dhuratave, mundëson raportimin e rasteve të dyshuara për mos deklaram apo deklarim të rremë të pasurive ose dhuratave të subjekteve deklaruese; dhe
- Tjetër, mundëson të raportoni rastet e natyrave të ndryshme, të cilat pastaj agjencia do t'i klasifikojë.

Gjatë vitit raportues kemi bërë zhvillime në përmirësimin e sistemit DMSA, tek moduli i deklarimit online, <https://e-deklarimi.rks-gov.net>, për të lehtësuar dhe përmirësuar deklarimin e pasurisë për subjektet deklaruese. Ky modul ka mundësuar deklarimin online të pasurisë për rreth 11 mijë subjekte deklaruese. Nga sistemi DMSA kemi gjeneruar mbi 11 mijë Regjistra të Deklarimit të Pasurisë gjatë vitit 2024, të cilët janë publikuar në ueb faqen e Agjencisë, www.apk-rks.net. Në modulën tjetër, të zyrarëve kontaktues, <https://pikatekontaktit.rks-gov.net>, janë bërë përmirësime dhe zhvillime të reja për përmirësimin e mangësive të evidentuara nga viti paraprak. Ky modul ju mundëson zyrarëve kontaktues në institucionet e tyre që të bëjnë regjistrimin, largimin, editimin dhe menaxhimin subjektet deklaruese në listën e institucionit të tyre. Nga ana tjetër, gjatë vitit raportues është punuar në zhvillimin e një moduli të ri në sistemin DMSA, modulën e Integritetit, i cili do të mundësoj digjitalizimin për zhvillimin dhe menaxhimin e Planeve të Integritetit. Moduli i planeve të integritetit do të jetë i gatshëm për përdorim në gjysmën e parë të vitit 2025.

Përmirësime dhe zhvillime janë bërë edhe në sistemin për menaxhimin e rasteve të deklarimit të pasurisë, sistemin DMSA-CMS. Përmirësimet e bëra kanë mundësuar një menaxhim efikas dhe të lehtë të verifikimit dhe kontrollit të plotë të pasurisë.

Gjatë vitit raportues, me financim të Ambasadës së Britanisë së Madhe në Kosovë, është zhvilluar aplikacioni mobil për sinjalizim, i cili do të jetë i përdorshëm për publikun gjatë vitit 2025. Ky aplikacion do të jetë i qasshëm për shkarkim në AppStore (IOS) dhe në PlayStore (Android), me emrin Sinjalizo (Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit), dhe do të përdoret për raportimin e rasteve të sinjalizimit, të cilat do të lidhen me modulën sinjalizimi të platformës Raporto Keqpërdorimin.

Projekti tjetër shumë i rëndësishëm në rritjen e cilësisë dhe sigurisë së të dhënave të APK, është ri-zhvillimi i dhomës së serverëve bazuar në ISO standarde. Me këtë projekt që është përmbyllë gjatë vitit raportues, është bërë konstruktimi dhe zhvillimi i data-qendrës së Agjencisë, duke përfshi edhe pajisje të TI-së, si për ruajtje të të dhënave, ashtu edhe për monitorim dhe menaxhim. Këtu është bërë edhe implementimi i sistemit të ri të kamerave për monitorim 24/7 të Agjencisë.

Meqenëse kemi pasur rritje të stafit të Agjencisë për vitin raportues, është bërë edhe furnizimi me pajisje të reja të TI-së për staf, si kompjuter, laptop, etj.

Në figurën vijuese është paraqitur numri i projekteve të realizuara të teknologjisë informative, i aplikacioneve dhe i shërbimeve elektronike të Agjencisë për vitet 2022, 2023 dhe 2024.




Figura 1. Paraqitja grafike e projekteve të TI-së, aplikacioneve, dhe e-Shërbimeve për periudhën 2022-2024

Përveç implementimeve të suksesshme që janë bërë në transformimin digjital të Agjencisë, gjatë vitit raportues është vazhduar suksesshëm të bëhet mirëmbajtja e sistemeve aktuale, si dhe e infrastrukturës së rrjetit kompjuterik.

TRAJTIMI I RASTEVE TË KONFLIKTIT TË INTERESIT

Një nga prioritetet kryesore të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit për vitin 2024 ka qenë parandalimi dhe menaxhimi i situatave të konfliktit të interesit. Në këtë aspekt, Agjencia ka vazhduar me detyrat dhe përgjegjësitë e saj dhe ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të identifikuar, parandaluar dhe menaxhuar situatat e tilla konform Ligjit Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Gjatë periudhës raportuese janar - dhjetor 2024, janë trajtuar gjithsej 220 raste.

Nga numri total i rasteve, 67 raste janë trajtuar sipas raportimeve nga jashtë, 72 raste janë iniciuar/trajtuar sipas kërkesës nga institucionet, 43 raste sipas kërkesës nga vet zyrtarët, 13 raste nga raportimet e mediave, 12 raste nga Organizatat joqeveritare, si dhe 13 prej tyre janë trajtuar sipas detyrës zyrtare (ex officio).

Krahasuar me vitet paraprake, përkatësisht me tri vitet e fundit, në vitin 2022 kanë qenë 233 raste, në vitin 2023 kanë qenë gjithsej 214 raste, ndërsa në vitin 2024 kanë qenë gjithsej 220 raste.




Figura 2. Paraqitja grafike e rasteve të trajtuara për konflikt të interesit për periudhën 2022-2024

DEKLARIMI I PASURISË

Deklarimi i pasurisë është komponentë e rëndësishme për forcimin e transparencës dhe luftimin e korrupsionit në sektorin publik. Procesi i deklarimit të pasurisë edhe gjatë vitit 2024 u karakterizua me rritjen e përgjegjesisë të zyrtarëve të lartë publikë për ta kryer këtë obligim ligjor brenda afateve ligjore.

Duke iu referuar të dhënave të deklaruara për 3 vitet e fundit, në vitin 2022 nga 4748 subjekte deklaruese, 4687 ose (98.72%) e kanë deklaruar pasurinë brenda afatit, ndërsa 61 ose (1.28%) nuk e kanë respektuar afatin ligjor, që nënkupton se e kanë bërë deklarin e pasurisë pas afatit ligjor për deklarimin e pasurisë. Në vitin 2023, me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-108, numri i subjekteve deklaruese është dyfishuar dhe është përcaktuar që deklarimi të bëhet vetëm në mënyrë elektronike, duke siguruar një proces më të shpejtë dhe të sigurt. Pra, në vitin 2023, 99.60% e subjekteve e kanë përmbushur detyrimin ligjor për deklarimin e pasurisë, duke reflektuar një rritje të ndjeshme të ndërgjegjësimit dhe angazhimit. Ndërsa në vitin 2024, duke e marrë parasysh faktin që për herë të parë sipas Ligjit Nr. 08/L-108 janë shtuar edhe dy kategori të reja, pozita deklaruese si mjekët dhe profesorët, me qëllim të rritjes së përgjegjesisë dhe transparencës ndaj publikut për këto profesione të rëndësishme. Sipas të dhënave të raportuara, në vitin 2024 nga 11168 subjekte deklaruese 11070 ose (99.12%) kanë respektuar afatin ligjor, ndërsa 98 ose (0.88%) nuk e kanë respektuar afatin ligjor.




Figura 3. Paraqitja grafike e deklaramit të pasurisë për periudhën 2022-2024

TRAJTIMI I RASTEVE TË SINJALIZIMIT

Në kuadër të mandatit të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit në aspekt të mbikëqyrjes dhe marrjes së masave të nevojshme sipas Ligjit Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, gjatë vitit 2024 Agjencia ka pranuar dhe evidentuar gjithsej 48 raste të sinjalizimit të jashtëm.

Krahasuar me vitet paraprake, përkatësisht me tre vitet e fundit, në vitin 2022 kanë qenë 17 raste të pranuar, në vitin 2023 janë pranuar 20 raste, derisa në vitin 2024 janë pranuar 48. Kjo tregon se prej viti në vit kemi një ngritje të nivelit të kulturës së sinjalizimit dhe të besimit që qytetarët kanë për të raportuar aktivitete të dyshimta ose të paligjshme, duke u mbështetur në mbrojtjen që ofron Ligji për sinjalizuesit.




Figura 4. Paraqitja grafike e rasteve të trajtuara të sinjalizimit për periudhën 2022-2024

ZBATIMI I LEGJISLACIONIT KUNDËR KORRUPSIONIT, SI DHE PLOTËSIMI DHE NDRYSHIMI I TIJ

Gjatë vitit 2024 Agjencia ka vazhduar misionin e saj drejtë zbatimit të legjislacionit si dhe përmirësimin e tij, përmes miratimit të akteve nënligjore si dhe dokumenteve të rëndësishme strategjike si: rregullore, metodologji, udhëzues praktik, duke i përmbushur kështu detyrimet e saj në aspekt të plotësisë dhe zbatimit të plotë të legjislacionit në fuqi. Veprimtaria e Agjencisë mbështetet në ligjet si në vijim:

- Ligjit Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit;
- Ligji Nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave;
- Ligji Nr. 06/L-011 Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik; si dhe
- Ligji Nr. 06/L-085 Për Mbrojtjen e Sinjalizuesve;

Në kuadër të kësaj, Agjencia ka vazhduar plotësimin e kornizës ligjore, miratimin e akteve nënligjore dhe dokumenteve strategjike si në vazhdim:

- Rregullorja Nr. 07/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit;
- Rregullorja Nr. 06/2024 për Shqiptimin e Gjobave dhe Masave tjera Sanksionuese nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit;
- Rregullorja Nr. 08/2024 e Punës së Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit;
- Rregullorja për Menaxhmentin e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit;
- Rregullore Nr. 05/2024 për Pranimin dhe Regjistrimin e Dhuratave nga Personat Zyrtarë;
- Rregullat 01-2024 për Menaxhimin e Pasurive jo-financiare në AKP;

- Kodi i Etikës dhe Mirësjelljes për Zyrtarët e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit;
- Udhëzues për Monitorimin dhe Raportimin e Zbatimit të Planit të Integritetit;

Varësisht nevojave dhe kërkesave të ndryshme ligjore, janë përpiluar parashtresa të shumta juridike (vendime, kërkesa, përgjigje, kontrata, memorandume mirëkuptimi), si dhe janë ofruar po ashtu, përgjigje, opinione apo këshilla të ndryshme profesionale për të gjitha njësitë organizative brenda institucionit, në analizimin e çështjeve të ndryshme brenda mandatit të institucionit dhe aktivitete të tjera që hyjnë në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi të Agjencisë.

RASTET E REFERUARA NGA AGJENCIA NË AUTORITETET E ZBATIMIT TË LIGJIT (PROKURORI DHE GJYKATA)

Gjatë periudhës raportuese në institucionet kompetente të drejtësisë si: Prokurori të Shtetit/Zyre të kryeprokurorit të Shtetit si dhe Gjykata, Agjencia ka përcjellë për procedim të mëtutjeshëm gjithsej 9 kallëzime penale dhe 34 informata në Prokurori të Shtetit, ndërsa 3 raste tjera në Gjykatën për Kundërvajtje. 8 kallëzime penale kanë të bëjnë me veprime të sanksionuara sipas nenit 430 të Kodit nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës “ Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare”, ndërsa 1 kallëzim penal ka të bëjë me veprime të sanksionuara sipas nenit 417 të Kodit Penal të Kosovës, për vepër penale “Konflikt i Interesit”.

3 rastet e përcjella në Gjykatën kompetente për Kundërvajtje, kanë të bëjnë me shkelje të dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, të cilat përbëjnë kundërvajtje.

Për më tepër në kuadër të sinjalizimit nga Agjencia janë përcjellë poashtu dhe 3 raste si informata, për shkak të dyshimit të arsyeshëm që ka pasur elemente të veprave penale dhe të njëjtën kohë për të vlerësuar nëse ekzistojnë prova të mjaftueshme apo duhet të sigurohen prova tjera, në mënyrë që të vazhdohen procedurat tjera të mëtejshme ligjore.

2 raste në Gjykatën për Kundërvajtje, kur raportet e sinjalizuesve nuk janë pranuar dhe trajtuar sipas detyrimeve ligjore, dy për shkak se janë marrë masa kundër sinjalizuesve, në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, si dhe në një rast kur institucioni përkatës nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për të caktuar Zyrtarin Përgjegjës.

INFORMATA STATISTIKORE PËR VENDIMET NË LIDHJE ME RASTET E REFERUARA NGA AGJENCIA

Nga informacionet e pranuar gjatë vitit 2024, nga Gjykatat respektive lidhur me rastet e dyshuara për korrupsion sipas aktakuzave të ngritura nga Prokuroritë kompetente mbi bazën e kallëzimeve penale të Agjencisë, janë nxjerr 17 Aktgjykime dënuese, 8 aktgjykime liruese si dhe 2 aktvendime refuzuese (hedhje të aktakuzave).

Nr.	Gjykata	Aktgjykim dënues	Aktgjykim lirues	Aktvendime
-----	---------	------------------	------------------	------------

1	GJTH. Prishtinë	8	7	2
2	GJTH. Prizren	1	-	-
3	GJTH. Gjilan	2	-	-
4	GJTH. Gjakovë	3	-	-
5	GJTH. Mitrovicë	3	1	-
GJITHSEJ		17	8	2

Tabela Nr.3 pasqyron të dhënat nga vendimet e gjykatave përkitazi me Nenin 437 të Kodit nr. 04/L-082 Penal të Kosovës përkatësisht 430 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Kosovës

Me aktgjykime dënuese Gjykatat kanë shqiptuar kryesisht dënime me gjobë, ka raste kur janë shqiptuar edhe dënime me kusht (dënime me gjobë dhe burgim), po ashtu edhe dënime me burgim efektiv.

Dënimet me gjobë janë shqiptuar në shumë prej 250 euro deri në 1000 euro. Këto dënime është caktuar që të paguhet kryesisht pas plotfuqishmërisë së aktgjykimeve dhe në disa raste me këste, me mundësinë e revokimit në dënime me burg, ku 20 euro do të llogaritet me një ditë burgimi në rast se i akuzuari nuk e paguan atë dhe e njëjta nuk mund të ekzekutohet me detyrim.

Dënimet me kusht kryesisht janë shqiptuar me dënime me burgim nga 3 deri në 10 muaj me kohë të verifikimit deri në 1 vit.

Ka raste kur Gjykata ka shqiptuar dënime me burgim efektiv, e të cilat me marrëveshje në mes Gjykatave dhe të dënuarve janë zëvendësuar me dënime me gjobë.

Aktgjykimet dënuese i referohen veprës penale nga neni 437 të Kodit nr. 04/L-082 Penal të Kosovës, përkatësisht 430 të Kodit nr.06/L-074 Penal të Kosovës, ku 9 raste për mos deklarim të pasurisë sipas paragrafit 1 të këtij neni, përkatësisht 6 raste janë për mos deklarim të rregullt vjetor të pasurisë e 2 raste për mos deklarim me rastin e mbarimit/shkarkimit nga funksioni dhe 1 raste për mos deklarim me rastin e marrjes së detyrës apo funksionit si dhe 8 raste për deklarim të rremë të pasurisë apo mos paraqitje të të dhënave të kërkuara në deklaratë sipas paragrafit 2 të këtij neni, përkatësisht 2 për mos paraqitje të saktë të të hyrave vjetore, 3 për mos paraqitje të biznesit (zotërimit të aksioneve në shoqëri tregtare), 1 për mos paraqitje të saktë të pasurisë së luajtshme (veturë) dhe 2 për mos paraqitje të saktë të pasurisë së paluajtshme.

Me aktgjykim lirues, 4 raste Gjykata ka liruar nga akuza të akuzuarit për mos deklarim të pasurisë sipas paragrafit 1, (2 raste për mos deklarim të rregullt vjetor të pasurisë dhe 2 raste me rastin e marrjes së detyrës apo funksionit), 4 raste për mos deklarim të pasurisë sipas paragrafit 2 (1 rast mos deklarim të pasurisë të luajtshme (veturë) dhe 3 rast për mos deklarim të pasurisë të paluajtshme).

Aktvendime refuzuese, Gjykatat kanë vendosur për këto raste (1 rast me mosdeklarim të pasurisë pas marrjes së detyrës apo funksionit si dhe 1 rast për mos paraqitje të biznesit (zotërimit të aksioneve në shoqëri tregtare).

PËRFAQËSIMI I RASTEVE NË GJYKATA

Gjatë vitit 2024, Agjencia ka përfaqësuar gjithsej në 31 raste të iniciuara në institucionet e drejtësisë. Të gjitha rastet kanë qenë të natyrës penale, në 27 prej këtyre rasteve ka përfaqësuar në Gjykata dhe në 4 raste në Prokurori. Çështjet penale për të cilat Agjencia ka përfaqësuar në Gjykata dhe Prokurori kanë qenë për vepër penale: “Mos deklarimi ose deklarimit i rrejshëm i pasurisë, i të ardhurave, dhuratave ose i dobisë tjetër materiale” sipas Kodit Penal të Kosovës.

Përfaqësimi i Agjencisë në Gjykata dhe Prokuroritë kompetente, është bërë në faza të ndryshme varësisht se në cilën fazë kanë qenë duke u zhvilluar procedurat për rastet konkrete.

PARANDALIMI I KONFLIKTIT TË INTERESIT NË USHTRIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE

Agjencia në kuadër të mandatit të saj në fushën e parandalimit të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, për periudhën raportuese ka vazhduar me punë në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi sipas ligjit, duke ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme hetimore administrative për trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit. Si rezultat i kësaj, Agjencia sipas vlerësimit varësisht natyrës së rasteve të trajtuara, ka dalë me rekomandime, këshilla, opinione si dhe vendime konkrete, sipas dispozitave të Ligjit Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Parandalimin e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të funksioneve publike, në institucione publike të vendit, Agjencia e ka realizuar bashkërisht edhe me Autoritetet përgjegjëse nëpër institucionet publike dhe në funksion të kësaj vazhdimisht ka ofruar mbështetje profesionale për to, për t'i përgatitur ato sa më mirë në identifikimin, trajtimin dhe zgjidhjen e rasteve të paraqitjes së situatave të mundshme të konfliktit të interesit brenda institucioneve të tyre respektive.

Veprimet e Agjencisë, edhe për vitin që po raportojmë janë ndërmarrë në mënyrë objektive, të paanshme dhe profesionale e në zbatim të legjislacionit relevant në fuqi. Kjo zakonisht bëhet përmes inicimit të rasteve sipas detyrës zyrtare, informacioneve të pranuar nga personat fizik apo juridik, informatat e pranuar në formë anonime dhe informatave nga publiku, me qëllim të parandalimit të konfliktit të interesit në institucionet publike dhe në shërbim të forcimit të integritetit dhe transparencës institucionale në Republikën e Kosovës.

Gjatë periudhës raportuese janar - dhjetor 2024, në funksion të parandalimit të konfliktit të interesit të pretenduar, janë paraqitur gjithsej 220 raste.

Nga numri total i rasteve, 67 raste janë trajtuar me raportim të jashtëm, 72 raste janë iniciuar/trajtuar me kërkesë të institucioneve, 43 raste me kërkesë nga vet zyrtaret, 13 raste janë trajtuar nga raportimet e mediave, 12 raste nga Organizatave joqeveritare, dhe 13 prej tyre janë trajtuar sipas detyrës zyrtare (ex officio).

Ndërsa krahasuar me vitet paraprake, përkatësisht me tri vitet e fundit, në periudhën raportuese janar - dhjetor 2024, Agjencia ka vazhduar me një dinamikë të njëjtë, sa i takon numrit të trajtimit të rasteve për parandalimin e konfliktit të interesit, e sidomos në aspektin e dhënies së përgjigjeve për situata të caktuara që lidhen me dyshime për papajtueshmëri ose ushtrim të funksionit në kushte të konfliktit të interesit.

Sa i përket numrit të rasteve të paraqitura në vitet paraprake, përkatësisht në tre vitet e fundit, në vitin 2022 kanë qenë 233 raste, në vitin 2023 kanë qenë 214 raste, ndërsa në vitin 2024 kanë qenë 220 raste.

Epilogu i rasteve të trajtuara nga Agjencia për periudhën raportuese është si në vijim: për 134 raste janë ofruar këshilla dhe opinione, në 15 raste subjektet e trajtuara nga Agjencia e kanë shmang konfliktin e interesit, 36 raste kanë rezultuar pa konflikt të interesit, 1 rast është përcjellë për procedurë të mëtutjeshme në Prokurorinë e Shtetit, ndërsa 3 raste tjera janë përcjellë në Gjykatën kompetente për kundërvajtje, si dhe 31 raste janë bartur në vitin vijues.

Nga numri 220 i rasteve të trajtuara, 54 prej tyre u iniciuan në mënyrë “sipas detyrës zyrtare” (*ex-officio*), 8 raste u trajtuan nga raportimet e adresuara nga mediat, dhe 2 raste të tjera u adresuan nga Organizata Jo-Qeveritare.

Vlen të theksohet se përveç raportimeve dhe kërkesave të sipërpërmendura për trajtimin e pretendimeve për konflikt të interesit, në Agjenci janë adresuar 13 raste për vlerësim përfundimtar të konfliktit të interesit edhe nga institucione ligj-zbatuese, si Prokuroria e shtetit dhe Policia e Kosovës.

Institucioni	Rastet e trajtuara	Rastet e shmangies nga K.I.	Rastet pa konflikt interesi	Rastet në Gjykatë	Rastet në Prokurori	Opinione Përgjigje	Rastet në Procedurë
Kuvendi i Kosovës	3	0	1	0	0	1	1
Qeveria (Min.Agjenc. Uni.)	85	3	15	1	0	56	10
Gjykatat	3	0	0	0	0	3	0
Prokuroritë	5	0	0	0	0	5	0
Institucionet e Pavarura	34	0	6	0	0	23	5
Ndërmarrjet Publike	35	3	4	1	1	19	7
Pushteti Lokal	55	9	10	1	0	27	8
Gjithsej	220	15	36	3	1	134	31

Tabela Nr.4 pasqyron rastet e trajtuara nga Agjencia gjatë vitit 2024

Për më tepër, sipas Ligjit Nr. 06/011 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, përkatësisht Nenit 20 të Ligjit, në raport me obligimet ligjore në aspekt të trajtimit të konfliktit të interesit nga autoritetet përgjegjëse të institucioneve publike, që përfshijnë udhëheqësit e drejtëpërdrejtë të zyrtarëve sipas hierarkisë brenda institucioneve, viti 2024 u karakterizua me trend afërsisht të njëjtë të numrit të rasteve të trajtuara nga autoritetet përgjegjëse brenda institucioneve publike.

Në kuptim të kësaj, krahasuar me 3 vitet e fundit ekziston një tendencë e ngritjes nga viti në vit e numrit të rasteve të trajtuara nga autoritetet përgjegjëse, dhe atë si në vijim: në vitin 2021 nga autoritetet

përgjegjëse u trajtuan 101 raste, në vitin 2022 u trajtuan 121 raste, në vitin 2023, janë trajtuar 181 raste, ndërsa për vitin raportues janë trajtuar gjithsej 185 raste nga autoritetet përgjegjëse.

Institucioni	Rastet e paraqitura në AP	Rastet e shmangies nga K.I.	Rastet pa konflikt interesi	Rastet me konflikt interesi/ procedurë disiplinore	Opinione Përgjigje	Rastet në Procedurë	Raste të dërguara në APK
Presidenca	0	0	0	0	0	0	0
Kuvendi i Kosovës	1	0	0	1	0	0	0
Qeveria (Min.Agjenc. Uni.)	82	31	21	4	14	1	11
Gjykatat	16	10	6	0	0	0	0
Prokuroritë	0	0	0	0	0	0	0
Institucionet e Pavarura	55	44	5	1	2	0	3
Ndërmarrjet Publike	9	8	0	0	0	0	1
Pushteti Lokal	22	22	0	0	0	0	0
Gjithsej	185	115	32	6	16	1	15

Tabela Nr .5 pasqyron specifikat e rastet e trajtuara nga Autoritetet Përgjegjëse gjatë vitit 2024

Përtej kësaj, në funksion të parandalimit të konfliktit të interesit, gjatë vitit 2024, Agjencia ka ofruar edhe 79 përgjigje, përmes komunikimit elektronik (e-mail-it zyrtar), për zyrtarët publik dhe institucionet publike sipas kërkesave të tyre.

Aktivitetet në funksion të forcimit dhe fuqizimit të Autoriteteve përgjegjëse

Me qëllim të rritjes së bashkëpunimit ndër-institucional në fushën e parandalimit të konfliktit të interesit, Departamenti për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, gjatë vitit 2024 kanë realizuar disa vizita në institucione të rëndësishme publike të vendit, në kuadër të së cilave janë zhvilluar takime me udhëheqës të lartë të atyre institucioneve dhe me autoritetet përgjegjëse të emëruara për parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesit në ato institucione.

Në këto takime të ndara, zyrtarët e Departamentit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit të APK-së, janë njoftuar për sfidat dhe përpjekjet që po ndërmarrin institucionet si: BQK, ZKA, Gjykata Kushtetuese, Universiteti i Prishtinës, për të identifikuar dhe adresuar sa me herët rastet e konfliktit të interesit nëpër institucionet e tyre përkatëse.



Ndërsa, gjatë aktiviteteve që Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit i ka organizuar në javën kundër Korrupsionit, Departamenti për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në aktivitetin e tij kryesor gjithë ditor me panelistët dhe pjesëmarrësit (autoritetet përgjegjëse të institucioneve) ka diskutuar temën: *“Parandalimi i konfliktit të interesit - parakusht për besim në institucione”*.

ANALIZA:

Numri i kërkesave për trajtimin e konfliktit të interesit, përkatësisht papajtueshmërive në ushtrimin e funksioneve publike vazhdon të jetë i madh. Kjo për faktin se edhe gjatë vitit raportues ka pas lëvizje me zgjedhje dhe emërimë në pozita drejtuese në institucionet dhe ndërmarrjet publike të vendit, por edhe për shkak se Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit tashmë shihet e kuptohet edhe nga jashtë si institucioni me kredibilitet për vlerësimin dhe trajtimin e situatave të dyshuara për konflikt interesi.

Pra, numri i madh i kërkesave për trajtimin e situatave të dyshuara për konflikt interesi, në njërin anë tregon besimin në ngritje të vazhdueshme dhe gatishmërinë e zyrtarëve publik dhe qytetarëve për të adresuar çështjet e konfliktit të interesit në Agjenci, si institucionin i specializuar për trajtimin e kësaj problematike, ndërsa, nga ana tjetër, ajo që është shqetësuese për Agjencinë, është fakti se përkundër fushatave sensibilizuese, këshillimeve si dhe trajnimeve të vazhdueshme që i bën Agjencia për autoritetet përgjegjëse, te ato akoma po shpërfaqet një hezitim, që zyrtarët publik apo udhëheqësit e tyre të drejtpërdrejtë, të vlerësojnë fillimisht vet, ashtu siç e kanë obligim ligjor, për të zgjidhur brenda institucioneve të tyre këto situata, e vetëm në raste të veçanta apo specifike ku është e domosdoshme të kërkohet përfshirja e Agjencisë.

Gjithashtu duhet theksuar se në këtë vit raportues, 11 kërkesa në Agjenci janë përcjellë përmes Policisë së Kosovës, për trajtim të konfliktit të interesit për rastet që janë raportuar dhe iniciuar direkt nga Prokuroritë e ndryshme apo edhe nga vet Policia e Kosovës.

Ndërsa, sa i takon natyrës dhe karakteristikave të vendimeve që Agjencia i ka nxjerrë gjatë vitit 2024, ka pas vendime të natyrave të ndryshme, por gjithnjë me qëllim të shmangies së vendimmarrjeve me konflikt interesi, apo papajtueshmërive në ushtrimin e funksioneve publike.

P.sh.:

- Pas vendimit me konstatim të konfliktit të interesit në vendimmarrje është anuluar kontrata e punësimit në Spitalin e Përgjithshëm në Mitrovicë, si dhe është shqiptuar masa sanksionuese ndaj zyrtarit.
- Përmes një vendimit të Agjencisë është anuluar konkursi në Komunë të Shtërpcës, për shkak të përzgjedhjes për punësim, në kundërshtim me kufizimet (ex-post) të nenit 18 të LPKI-së;
- Në Universitetin e Prishtinës, në dy raste ka pas vendimmarrje në kushte të konfliktit të interesit, për të cilat Agjencia pas hetimit administrativ ka kërkuar që rastet të kthehen në rishqyrtim, ndërsa në një rast tjetër është iniciuar procedurë disiplinore për shkak të mos shmangies së konfliktit të interesit.
- Me përgjigje për palën, nga ana e Agjencisë, është konstatuar konflikti i interesit lidhur me emërimin/zgjedhjen e një anëtar të Këshillit Prokurorial, me ç'rast i njëjti ka heq dorë nga ushtrimi i këtij funksioni.
- Për shkak të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik, ka pas një dorëheqje nga pozita e Anëtarit të Bordit të një ndërmarrje publike lokale, për shkak se i njëjti ka vazhduar të mbajë funksion drejtues në OJQ.
- Pas vendimit të Agjencisë për konstatimin e konfliktit të interesit është anuluar akti administrativ lidhur me punësimin në kushte të vendimmarrjes me konflikti interesi, në Korporatën Energjetike të Kosovës;
- Opinioni i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, ka rezultuar me anulim të konkursit për pozitën e një drejtori në kuadër të MKRS-së.
- Opinioni i Agjencisë ka ndryshuar përbërjen e një komisioni vlerësues në proces të prokurimit publik në Ministrinë e Shëndetësisë,
- Përgjigje sqaruese për parandalimin e konfliktit të interesit në procesin e zgjedhjes së anëtarëve të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës.
- Opinion për ndërmarrjen e masave për parandalimin e konfliktit të interesit nga organi mbikëqyrës në Agjenci të pavarur.

Në vijim një pasqyrë e përmbledhur e veprimeve të dhe ndaj zyrtareve të lartë publik për të shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksioneve publike:

- **13** dorëheqje nga funksionet drejtuese në Organizata Jo Qeveritare;
- **3** dorëheqje nga funksioni menaxhuese/drejtues dhe/ose person i autorizuar në biznese private;
- **1** dorëheqje nga një funksion publik për shkak të papajtueshmërisë me një funksion tjetër publik;
- **1** dorëheqje nga komisioni vlerësues për procese të prokurimit publik;
- **1** procedurë disiplinore në institucion përkatës për zyrtarin;
- **1** rast është iniciuar me kallëzim penal;
- **2** vendime të gjykatave me shqiptim gjobe për zyrtarët e lartë;

DEKLARIMI SIPAS LLOJEVE

Bazuar në obligimet ligjore të përcaktuara me Ligjin nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave, Agjencia ka vazhduar ta mbikëqyrë pasurinë e subjekteve deklaruese të deklaruara në Deklarimin e rregullt vjetor, Deklarimin me marrjen e detyrës dhe Deklarimin pas mbarimit apo shkarkimit nga funksioni.

Deklarimi i rregullt vjetor - Zyrtarët e lartë publik kanë për obligim deklarin e rregullt vjetor të pasurisë për çdo vit gjatë tërë kohës së punës në shërbimin publik, sipas afateve të përcaktuara me ligj dhe janë të obliguar ta deklarojnë gjendjen e pasurive të tyre në APK, nga 1 deri më 31 mars të çdo viti për vitin paraprak nga 1 janar deri më 31 dhjetor. Deklarimin e rregullt vjetor për vitin 2024 kanë qenë të obliguar ta bëjnë gjithsej **7906** subjekte deklaruese.

Nga numri i përgjithshëm e kanë deklaruar pasurinë **7816**, prej tyre 90 subjekte deklaruese nuk e kanë deklaruar pasurinë brenda afatit.

Lista e Deklarimit të rregullt vjetor sipas Institucioneve

Institucionet	Zyrtarët e obliguar ta deklarojnë pasurinë	Kanë deklaruar	Nuk kanë deklaruar
Presidenca	19	19	0
Kuvendi	150	150	0
Qeveria	4673	4606	67
Gjykatat	529	528	1
Prokuroritë	233	233	0
Institucionet e Pavarura	738	734	4
Komunat e Kosovës	1079	1063	16
Ndërmarrjet Publike	485	483	2
TOTALI	7906	7816	90

Për periudhën raportuese janar- dhjetor 2024, gjendja e përgjithshme e procesit të deklarimit të rregullt vjetor të pasurisë paraqitet përmes tabelës në vijim përfshirë krahasimet me vitin 2022 dhe vitin 2023.

Vitet	Të obliguar për deklarim	Kanë deklaruar në afat	Nuk kanë respektuar afatin
2022	4748	4687 (98.72%)	61 (1.28%)
2023	4709	4698 (99.77%)	11 (0.23%)
2024	7906	7816 (98.86%)	90 (1.14%)

Tabela Nr .6 krahasimet për vitet 2022-2024 lidhur me procesin e deklarimit të rregullt vjetor të pasurisë

Deklarimi me marrjen e detyrës - Zyrtarët e lartë publik të cilët fillojnë punën në shërbimin publik në mënyrë të plotë dhe reale deklarojnë pasurinë e tyre brenda afatit ligjor në periudhën prej 30 ditësh nga dita e marrjes së detyrës.

Gjatë vitit raportues deklarimin e pasurisë kanë pasur obligim të deklarojnë edhe kategoritë e reja, të cilat për herë të parë janë kategorizuar si subjekte deklaruese. Të obliguar për deklarimin e pasurisë kanë qenë **3161**, kanë deklaruar pasurinë brenda afatit kohor **3153**, ndërsa **8** prej tyre nuk e kanë deklaruar pasurinë brenda afatit të përcaktuar ligjor.

Për periudhën raportuese janar- dhjetor 2024, gjendja e përgjithshme e procesit të deklarimit të pasurisë deklarimit me marrjen e detyrës, paraqitet në tabelën në vijim, përfshirë krahasimet me vitin 2022 dhe vitin 2023.

Vitet	Të obliguar për deklarim	Kanë deklaruar në afat	Nuk kanë respektuar afatin
2022	270	229 (84.82%)	41 (15.18%)
2023	4377	4350 (99.38%)	27(0.62%)
2024	3161	3153 (99.74%)	8 (0.26%)

Tabela Nr .7 krahasimet për vitet 2022-2024 lidhur me procesin e deklarimit me marrje të detyrës

Deklarimi pas mbarimit apo shkarkimit nga funksioni – Me rastin e përfundimit të angazhimit në pozitën publike, zyrtarët publik janë të obliguar ta bëjnë deklarimin e pasurisë brenda afatit tridhjetë (30) ditor.

Gjatë vitit raportues Agjencia ka pranuar informacione nga zyrtarët kontaktues se ushtrimin e funksionit publik e kanë përfunduar **101** subjekte deklaruese, të obliguar të deklarojnë pasurinë pas largimit nga funksioni publik.

Për periudhën raportuese janar- dhjetor 2024, gjendja e përgjithshme e procesit të deklarimit pas mbarimit të funksionit publik paraqitet në tabelën në vijim për vitin 2022, 2023 dhe 2024.

Vitet	Të obliguar për deklaram	Kanë deklaruar brenda afatit	Nuk kanë deklaruar brenda afatit
2022	107	89 (83.18%)	18 (16.82%)
2023	545	545 (100%)	0 (0 %)
2024	101	101(100%)	0 (0 %)

Tabela Nr .8 krahasimet për vitet 2022-2024 lidhur me procesin e deklarimit pas mbarimit të funksionit publik

Në kuadër të zbatimit të ligjit dhe ndërmarrjen e veprimeve për mos respektim të obligimeve ligjore për deklarimin e rregullt të pasurisë, deklarimin me rastin e marrjes së detyrës dhe deklarimit me rastin e përfundimit të funksionit publik, në vitin 2023 Agjencia ka vazhduar me hetim të mëtutjeshëm në procedura administrative për 1716 raste.

Bazuar në të dhënat e raportuara gjatë vitit 2024, për të gjitha llojet e deklarimit të pasurisë, kanë qenë të obliguar ta bëjnë deklarimin 11168 zyrtar të lartë publik, sikurse në tabelën në vijim.

Lloji i deklarimit	Të obliguar
Deklarimi i rregullt vjetor	7906
Me marrjen e detyrës	3161
Pas mbarimit apo shkarkimit nga funksioni	101
Numri i përgjithshëm	11168

Tabela Nr .9 pasqyron të dhënat lidhur me obligimin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë sipas llojeve të deklarimit

Sipas Ligjit nr. 08/L-017, për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Ligjit nr. 08/L-108, për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave, Rregullores nr.06/2024 për Shqiptimin e Gjobjave si dhe Masave Tjera Sanksionuese nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, si dhe në kuptim të zbatimit të dispozitave të Ligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, gjatë vitit 2024 Agjencia ka shqiptuar gjoba ndaj 89 subjekteve deklaruese në shumën totale prej 21806.15 Euro, për 7 subjekte deklaruese ka shqiptuar masën “qortim publik” dhe për 2 subjekte deklaruese ka pushuar procedurat për shkak se kanë ndërruar jetë.

KONTROLLI I PASURISË

Sipas Ligjit Nr. 08/L-108 për Deklarimin, Agjencia bën kontrollë formularëve të deklarimit të pasurisë të subjekteve deklaruese zyAPK ka zhvilluar kontrollin e plotë të formularëve për deklarim të pasurisë të paraqitur nga subjektet deklaruese. Agjencia ka qenë e përkushtuar gjatë gjithë kohës për trajtimin e rasteve brenda afateve kohore, mirëpo duke pasur parasysh çështjet teknike të zhvillimit të kontrollit përmes sistemit elektronik DMSA-CMS, kontrolli i plotë ka filluar me vonesë gjatë vitit 2023, është filluar me procesin e grumbullimit të informacioneve nga institucionet relevante për të bërë verifikimin e deklarimeve të pasurisë së deklaruar në Agjenci nga subjektet deklaruese. Në vitin 2024 të gjitha rastet e kontrollit të plotë janë bartur në vitin 2025 për shkak të mungesës së stafit dhe punëve të shumta gjatë vitit, dhe si rezultat kontrolli ka filluar me vonesë. Në vitin 2023 janë bartur për vitin 2024, 1708 raste sipas listës së kontrollit, si dhe 8 raste që i kemi pranuar sipas informacionit, pra gjithsej 1716 raste.




Figura 5. Paraqitja grafike e bartjes së rasteve për kontrollë të pasurisë ndër vite

Kontrolli i plotë - Bazuar në obligimet ligjore, Agjencia ka zhvilluar procesin e kontrollit të plotë të pasurisë për ta verifikuar saktësinë dhe vërtetësinë e të dhënave të deklaruara në formularët e deklarimit të pasurisë për zyrtarët publik të cilët deklarojnë pasurinë.

Kontrolli i pasurisë për subjektet deklaruuese është bërë sipas kategorizimit të përcaktuar me Ligjin nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave. Të gjitha subjektet deklaruuese sipas nenit 4 paragrafit 1.1 deri në paragrafin 1.18, si dhe subjektet deklaruuese nga paragrafi 1.19 deri në paragrafin 1.38, 1/3 e subjekteve deklaruuese iu kanë nënshtruar kontrollit sipas përzgjedhjes me short. Subjektet deklaruuese të cilat sipas nenit 5 të ligjit, për herë të parë e kanë deklaruar pasurinë, 50 prej tyre iu kanë nënshtruar kontrollit sipas përzgjedhjes me short.

Procesi i kontrollit të plotë të pasurisë ka filluar duke bërë krahasimin e të dhënave të deklaruara ndër vite, krahasimin e të dhënave të pranuar nga institucionet tjera si: Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve, Agjencia Kadastrale e Kosovës, Ministria e Financave- Departamenti i Tatimit në Pronë, Thesari, Ndërmarrjet Publike, Agjencia e Regjistrimit Civil, Administrata Tatimore e Kosovës, Universitetet Publike/Private dhe të tjera.

Rastet e bartura nga viti 2023 në vitin 2024 janë përfunduar nga kontrolli i plotë, dhe nga numri i përgjithshëm i subjekteve deklaruuese që iu kanë nënshtruar kontrollit të plotë të pasurisë është realizuar për 1708 subjekte deklaruuese, sipas obligimit ligjor që ka përcaktuar kontrollin e plotë, ndërsa përveç listës së kontrollit të plotë të pasurisë.

Numri i rasteve të bartura	Rastet e mbyllura	Rastet e proceduara për kallëzime penale në Prokurori	Raste e proceduara si informatë në Prokurori	Raste e proceduara si informatë në Administratën Tatimore të Kosovës	Rastet e dërguar me vërejtje subjekteve deklaruese
1708	1625	8	34	1	40

Tabela Nr 10 pasqyron të dhënat nga kontrolli i plotë lidhur me rastet e përfunduara dhe të bartura nga viti 2023-2024

Gjatë vitit 2024, kontrolli i pasurisë ka filluar për subjektet deklaruese sipas Ligjit nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave. Të gjitha subjektet deklaruese sipas nenit 4 paragrafit 1.1 deri në paragrafin 1.18, si dhe subjektet deklaruese nga paragrafi 1.19 deri në paragrafin 1.38, 1/3 e subjekteve deklaruese iu kanë nënshtruar kontrollit sipas përzgjedhjes me short. Subjektet deklaruese që kanë deklaruar pasurinë për herë të parë dhe janë të përcaktuar me nenin 5, 70 subjekte deklaruese i janë nënshtruar kontrollit sipas përzgjedhjes me short. Agjencia ka iniciuar për trajtim ex-officio edhe 15 raste për subjektet deklaruese, apo sipas informatave të raportuara nga qytetarët përmes formave të ndryshme.

Sipas obligimit ligjor	ex –officio (anonime)	Gjithsej në kontroll	Të mbyllura	Të proceduara me kallëzim penal dhe informatë në Prokurori	Të bartura 2025
1321	15	1336	12	3	1321

Tabela Nr. 11 pasqyron të dhënat nga kontrolli i plotë gjatë vitit 2024 si dhe rezultatet e gjetjeve nga kontrolli i plotë

Vitet	Kontrolli i plotë	Rastet e mbyllura	Rastet e proceduara për procedim në procedurë administrative	Raste të bartura në vitin 2024	Rastet e trajtuara (ex-officio) sipas informatave anonime apo OJQ
2022	973	916 % (94.14%)	57 % (5.86%)	13 (1.34%)	41
2023	1735	19 (1.09%)	0	1716(98.90%)	27
2024	1336	12	3	1321	12

Tabela Nr. 12 pasqyron të dhënat nga kontrolli i plotë i pasurisë për tre vite 2022-2024

DEKLARIMI I DHURATAVE TË PRANUARA NGA INSTITUCIONET

Sipas Ligjit nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave dhe Rregullores Nr. 05/2024, institucionet obligohen të emërojnë zyrtarët përgjegjës për mbajtjen e regjistrimit të dhuratave. Ky regjistër duhet të përmbajë të gjitha dhuratat që janë pranuar, vlerën e tyre përkatëse dhe emrat e personave që i kanë dhuruar ato.

Zyrtari përgjegjës për regjistrimin e dhuratave duhet të mbajë regjistrin e dhuratave për çdo person zyrtar që ka marrë dhurata, në përputhje me detyrat e tij apo të saj brenda institucioneve përkatëse. Ky proces ka për qëllim të sigurojë transparencën dhe kontrollin mbi dhuratat që mund të ndikojnë në punën dhe vendimmarrjen e zyrtarëve.

Dorëzimi i Formularit të Dhuratave

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit deri më 1 mars 2024, ka pranuar njoftime nga gjithsej 200 institucione. Nga këto, 24 institucione kanë deklaruar se kanë pranuar dhurata, ndërsa 169 institucione kanë njoftuar se nuk kanë pranuar asnjë dhuratë gjatë vitit të kaluar. Ky raportim tregon një nivel të lartë të transparencës dhe përputhshmërisë me detyrimet ligjore për regjistrimin e dhuratave në vitin paraprak.

Megjithatë, disa sfida vazhdojnë të ekzistojnë, 2 institucione të nivelit lokal nuk kanë emëruar ende zyrtarin përgjegjës, duke ngritur shqetësime për mundësinë e mos-raportimit të plotë dhe korrekt të dhuratave në nivelin lokal. Për më tepër, 1 institucion nuk ka dorëzuar raportet përkatëse lidhur me dhuratat e pranuar, duke shkelur kërkesat e përcaktuara nga legjislacioni për transparencën dhe llogaridhënien.

Ndërsa në një rast tjetër, në 2 institucione zyrtarët përgjegjës të emëruar janë aktualisht në procese ankimi, gjë që ka kufizuar aksesin e tyre në e-mailat zyrtar, duke penguar kështu mundësinë për raportim të rregullt dhe të saktë, ndërkohë, një institucion tjetër ka treguar se ka kufizime ligjore sa i përket raportimit (AKI).

Ky informacion tregon se, ndërkohë që një pjesë e institucioneve ka treguar përputhshmëri me kërkesat ligjore, ende mbeten disa sfida në implementimin e plotë të praktikave të duhura të raportimit, veçanërisht në nivelin lokal dhe në disa institucione me probleme të brendshme administrative.

Institucionet të cilat kanë dorëzuar kopjet e regjistrit të dhuratave me të dhënat e specifikuar, gjatë këtij viti për vitin paraprak janë institucionet e listuara në tabelën si më poshtë:

Nr.	Institucionet	Dhurata protokollare	Dhurata të rastit	Numri i përgjithshëm
1.	Zyra e Presidentes	27	0	27
2.	Kuvendi i Kosovës	22	5	27
3.	Zyra e Kryeministrit	67	116	183
4.	Gjykata Kushtetuese e Kosovës	10	0	10
5.	Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës	4	0	4
6.	Zyra Kombëtare e Auditimit	2	2	4
7.	Banka Qendrore e Kosovës	103	53	156
8.	Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit	3	0	3
9.	Ministria e Drejtësisë	5	0	5
10.	Ministria e Punëve të Brendshme	10	0	10
11.	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	41	33	74

12.	Ministria e Financave, Punës dhe Transefereve	0	5	5
13.	Ministria e Ekonomisë	0	7	7
14.	Njësia e Inteligjencës Financiare	29	0	29
15.	Dogana e Kosovës	0	9	9
16.	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	18	0	18
17.	Akademia e Drejtësisë	2	0	2
18.	SHSKUK-QKUK	3	0	3
19.	Telekomi i Kosovës	3	1	4
20.	Autoriteti i Konkurrencës së Republikës së Kosovës	0	8	8
21.	Fondi i Sigurimit të Depozitave në Kosovë	1	8	9
22.	Zyra e Rregullatorit për Energji	10	0	10
23.	Komuna Ferizaj	12	0	12
24.	Komuna e Pejës	2	0	2
	Gjithsej	374	247	621

Tabela Nr. 13 Lista e institucioneve të cilat kanë dorëzuar kopjet e regjistrit të dhuratave

Gjatë vitit 2024, zyrtarë nga Agjencia kanë realizuar disa vizita nëpër institucione. Nga data 17.10.2024 deri me 18.11.2024, janë inspektuar dhe audituar 17 institucione sa i përket mbajtjes dhe regjistrimit të dhuratave të deklaruara nga personat zyrtarë në këto institucione për vitin paraprak janar-dhjetor 2023.

Po ashtu, është bërë inspektim dhe auditim nëse këto institucione i kanë ekspozuar dhuratat në këndin e veçantë dhe të qashtëm për palët dhe publikun. Si rezultat, nga 17 institucione, 13 prej tyre kanë të siguruara këndet e dhuratave, ndërsa 4 nga këto institucione nuk kanë siguruar këndin e dhuratave, sic është e përcaktuar me ligj, dhe si të tilla iu është kërkuar të përmbushin këtë obligim ligjor.

Institucionet që janë inspektuar dhe të cilat kanë pasur të siguruara këndin e dhuratave janë: Zyra e Presidentes, Kuvendi i Kosovës, Zyra e Kryeministrit, Zyra Kombëtare e Auditimit, Akademia e Drejtësisë, Gjykata Kushtetuese e Kosovës, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, Banka Qendrore e Kosovës, Fondi i Sigurimit të Depozitave në Kosovë, Komuna e Prishtinës. Ministria e Drejtësisë.

Institucionet që nuk kanë siguruar këndin e dhuratave janë: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Ministria e Punëve të Brendshme. Fondi i Kosovës për Efijencë të Energjisë.

Zyrtarët e Agjencisë që mërren me inspektimin dhe auditimin e dhuratave, sipas detyrës zyrtare nëpërmjet zyrtarëve kontaktues brenda institucioneve, kanë kërkuar nga institucionet e sektorit publik që ta njoftojnë Agjencinë lidhur me krijimin e rregullave të brendshme, që përmes akteve nënligjore të përcaktojnë rregulla dhe procedura insitucionale lidhur me dhuratat, favorët.

Nga 201 institucione, **167** kanë deklaruar se nuk kanë dispozita të cilat rregullojnë pranimin, evidentimin dhe kërkimin e dhuratave, ndërsa **30** prej tyre kanë deklaruar se kanë krijuar rregulla lidhur me dhuratat brenda akteve nënligjore.

Në këtë drejtim, sa i përket rregullativës së brendshme ligjore institucionale lidhur me dhuratat dhe favorët, nga 167 institucione për të cilat Agjencia ka pranuar përgjegje se nuk kanë rregulla të brendshme, nga 42 ndërmarrjet publike, 31 prej tyre kanë raportuar se nuk kanë rregulla të brendshme të cilat rregullojnë ndalimin dhe pranimin e dhuratave, ndërsa 11 kanë raportuar se kanë krijuar dispozita brenda akteve të brendshme.

Nga 86 institucione të nivelit qendror, 7 prej tyre kanë raportuar se kanë krijuar dispozita brenda akteve të brendshme lidhur me dhuratat, ndërsa 79 kanë raportuar se nuk kanë rregulla të brendshme të cilat rregullojnë ndalimin dhe pranimin e dhuratave.

Nga 34 institucione të pavarura, 7 prej tyre ka raportuar se kanë krijuar dispozita brenda akteve të brendshme lidhur me dhuratat, ndërsa 27 kanë raportuar se nuk kanë dispozita të brendshme të cilat rregullojnë ndalimin dhe pranimin e dhuratave.

Nga 38 institucione të nivelit komunal/Komuna të Republikës së Kosovës, 4 prej tyre kanë krijuar dispozita brenda akteve të brendshme, ndërsa 30 kanë raportuar se nuk kanë dispozita të brendshme të cilat rregullojnë ndalimin dhe pranimin e dhuratave, 4 komuna nuk janë përgjigjur deri më tani.

Institucionet	Numri i përgjithshëm	Nuk kanë rregulla të brendshme	Kanë rregulla të brendshme	Pa përgjigje
Ndërmarrjet Publike	42	31	11	
Niveli Qendror	86	79	7	
Institucionet e Pavarura	34	27	7	
Komunat e Republikës së Kosovës	38	30	4	4
TOTALI	201	167	30	4

Tabela Nr. 14 Numri i përgjithshëm i institucioneve

VLERËSIMI I RREZIKUT DHE I AKTEVE LIGJORE KUNDËR KORRUPSION

Sipas Ligjit Nr. 08/L-017 të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, Nenit 26, paragrafi 1 të ligjit, Agjencia bën vlerësimin e rreziqeve të korrupsionit në fusha apo sektorë të ndryshëm.

Në drejtim të zbatimit të kësaj kompetence, Agjencia gjatë vitit raportues 2024, është përkrahë nga Projekti i Këshillit të Evropës kundër Krimin Ekonomik (PECK III), në procesin e identifikimit dhe përzgjedhjes së sektorëve me rrezik të lartë dhe të ultë të korrupsionit, për vlerësimin e thelluar të rrezikut sipas Udhëzuesit për Hartëzimin e Rrezikut nga Korrupsioni të zhvilluar nga Divizioni për Krim Ekonomik dhe Bashkëpunim i Këshillit të Evropës.

Fillimisht ky udhëzues është përshtat për kontekstin e Kosovës dhe gjatë zbatimit, me rastin e grumbullimit të informacionit dhe dokumentacionit përkatës, ka vazhduar përshtatja më tutje.

Në kuadër të këtij ushtrimi Agjencia ka bërë hartëzimin e rreziqeve nga korrupsioni në 115 institucione shtetërore dhe 44 ndërmarrje publike. Kjo me qëllim për të identifikuar dhe vlerësuar sektorë, aktivitete dhe funksione me rrezik më të lartë dhe ato me rrezik të ulët nga korrupsioni në nivel kombëtar.

Për këtë qëllim, Agjencia ka ndërmarrë një sërë aktivitetesh të rëndësishme për mbledhjen, analizimin dhe vlerësimin e të dhënave mbi rrezikun e korrupsionit për institucionet shtetërore dhe ndërmarrjet publike të përfshira në këtë proces.

Procesi ka filluar me identifikimin e 115 institucioneve shtetërore dhe 44 ndërmarrjeve publike, si subjekte të cilat kanë mundur që ti nënshtrohen vlerësimit sipas udhëzuesit të lartcekur. Janë identifikuar personat përgjegjës dhe kontaktet e tyre.

Ka pasuar organizimi i 3 takimeve me përfaqësues nga institucionet shtetërore dhe ndërmarrjet publike për të shpjeguar metodologjinë dhe rëndësinë e procesit të hartëzimit të korrupsionit. Këto takime kanë shërbyer për informimin e përfaqësuesve të institucioneve shtetërore dhe ndërmarrjeve publike mbi rolin e tyre në proces, si dhe angazhimin e tyre në ofrimin e të dhënave të nevojshme.

Hapi i radhës ka përfshirë përgatitjen dhe përshtatjen e pyetësorit, të detajuar për mbledhjen e të dhënave mbi treguesit e faktorëve të rrezikut, treguesve të keqpërdorimit dhe faktorëve zbutës të korrupsionit, i cili u është shpërndarë subjekteve të vlerësimit. Me rastin e shpërndarjes së pyetësorit janë kontaktuar të gjithë personat përgjegjës prej të cilëve është kërkuar konfirmimi i pranimit të pyetësorit. Institucionet ishin përgjegjëse për plotësimin e pyetësorëve dhe ofrimin e dokumenteve mbështetëse. Afati për grumbullimin e të dhënave ka qenë fleksibil. Gjatë gjithë kohës sa është mundur grumbullimi i të dhënave zyrtarët përgjegjës nga Agjencia kanë kontaktuar rregullisht me zyrtarët përgjegjës të subjekteve të vlerësuar, për sigurimin e të dhënave sa më cilësore.

Pyetësori është përbërë prej dy shtojcave. Nga subjektet e vlerësuar është kërkuar që në lidhje me të dhënat e ofruara të japin deklaratën nën betim për të konfirmuar vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave, informacionit dhe dokumentacionit të ofruar.

Në rastet kur të dhënat ishin të paqarta ose të paplota, Agjencia ka bërë kërkesa vijuese. Pasi të dhënat arritën nivelin optimal të plotësisë dhe cilësisë, u krye vlerësimi, ku Agjencia u përqendrua në analizimin dhe verifikimin e tyre. Ky proces gjithashtu ka përfshi krahasimin e informacionit të marrë nga institucionet me burime të tjera si p.sh. (institucione përgjegjëse si Agjencia për Informim dhe Privatësi, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Komisioni Rregullativ i Prokurimit) për evitimin e ndonjë mospërputhjeje apo pasaktësie eventuale.

Gjithashtu, Agjencia verifikoi të dhënat e mbledhura, edhe me të dhënat e saj të brendshme për çështjet e rasteve të sinjalizimit, deklarimit të pasurisë dhe dhuratave, parandalimit të konfliktit të interesit dhe planeve të integritetit. Këto hapa u ndërmorën për të siguruar një vlerësim të saktë dhe të besueshëm të rrezikut nga korrupsioni, duke krijuar një bazë të të dhënave të strukturuar dhe të dokumentuar.

Një pjesë e rëndësishme e procesit përfshinte ofrimin e pakursyer të ndihmës për përfaqësuesit e institucioneve për plotësimin e pyetësorëve dhe për të shpjeguar në detaje metodologjinë e hartëzimit të rreziqeve.

Në përfundim të gjithë këtyre aktiviteteve, është hartu raporti final, i cili përmban analizën e të dhënave, rezultatet e vlerësimit për rrezikun e korrupsionit në institucionet shtetërore dhe ndërmarrjet publike i cili është publikuar dhe për informacione shtesë gjendet në ëeb faqen e Agjencisë, në linkun si në vijim: https://apk-rks.net/wp-content/uploads/2024/12/2024-Gusht-Raporti-Hartezimi-i-Rrezikut-nga-Korrupsioni_ALB_compressed.pdf.

Ky proces përmes hartëzimit të rrezikut të korrupsionit në institucionet shtetërore dhe ndërmarrje publike të vlerësuar ka ndihmuar dhe shërben si orientim për identifikimin e sektorëve më të ekspozuar dhe atyre më pak të ekspozuar ndaj korrupsionit në Kosovë, si dhe kontribuon në ofrimin e të dhënave të vlefshme për vendimmarrësit që përmes veprimit të forcojnë dhe rrisin nivelin e transparencës dhe llogaridhënies në sektorin publik.

Vlerësimi i akteve ligjore kundër korrupsionit

Vlerësimi i akteve ligjore kundër korrupsionit, po ashtu, parashihet si masë parandaluese që sipas nenit 27 paragrafi 1 të Ligjit nr. 08/L-017, përfshin vlerësimin e rreziqeve dhe zbrazëtirave në projektligjet, projekt-aktet nënligjore, aktet ligjore dhe aktet nënligjore që janë ende në zbatim të cilat potencialisht mund të rrisin korrupsionin.

Agjencia gjatë vitit 2024, nuk ka pranuar ndonjë kërkesë nga organet propozuese për të vlerësuar rreziqet dhe zbrazëtirat që potencialisht mund ta rrisin korrupsionin, megjithatë me vetiniciativë në përputhje me dispozitën e lartcekur të Ligjit nr. 08/L-017, si dhe bazuar në Metodologjinë për vlerësim të korrupsionit në legjislacion, të miratuar nga Agjencia në vitin 2023, ka realizuar vlerësimin e disa projekt akteve normative me qëllim identifikimin dhe minimizimin e rreziqeve të korrupsionit në kornizën ligjore të Kosovës.

Fillimisht, Agjencia për zbatimin e kësaj metodologjie ka organizuar punëtori 2 ditore, qëllimi i së cilës ishte të mbulojë teorinë dhe praktikën e vlerësimit të rrezikut të korrupsionit në projekt aktet normative dhe aktet normative si dhe ti ofrojë stafit aftësitë e nevojshme për të kryer vlerësimet e tilla në mënyrë efektive dhe efikase.

Agjencia, gjatë vitit 2024 ka bërë vlerësimin e projekt akteve ligjore si në vijim:

- Projekt Ligji për Shërbimin e Jashtëm;
- Draft Rregullorja për Angazhimin e Bashkëpunëtorëve Profesional në Teatrin Kombëtar të Kosovës;
- Draft Rregullorja për Angazhimin e Bashkëpunëtorëve Profesional në Galerinë Kombëtare të Kosovës;
- Draft Rregullorja për Angazhimin e Bashkëpunëtorëve Profesional në Baletin Kombëtar të Kosovës;
- Draft Udhëzimit Administrativ për plotësim – ndryshim të UA nr. 25/22012, Licencimi i Bartësve Privat të Arsimit të Lartë;
- Projekt Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) – NR.XX/2024 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MA-nr.22/2005 për Licencimin e Ambulancave, Stacioneve dhe Klinikave Veterinare.

Në identifikimin për vlerësimin e tyre, kanë shërbyer si orientim gjetjet nga procesi i hartëzimit të rrezikut të korrupsionit.

Të gjeturat nga vlerësimi i këtyre projekt akteve janë në proces të finalizimit që të përcillen si rekomandime te Agjencisë te autoritetet përkatëse sponsorizuese.

Në këtë kontekst, Agjencia ka ndërmarrë një sërë hapash për të analizuar dhe vlerësuar rreziqet dhe zbrazëtitat që potencialisht mund të rrisin korrupsionin dhe nëse këto projekt akte normative janë në pajtim me standardet ndërkombëtare. Fillimisht janë kontaktuar dhe janë mbajtur takime me Departamentet Ligjore përkatëse të Ministrive sponsorizuese të projekt akteve ligjore të vlerësuara, për tu pasuar me disa takime të brendshme të njësisë përkatëse brenda Agjencisë, me qëllim të unifikimit të praktikës në zbatimin e Metodologjisë të Agjencisë për vlerësim të korrupsionit në legjislacion.

Planet e Integritetit

Obligimi për miratimin e planeve të integritetit nga Institucionet Publike, u fuqizua, përmes miratimit të Ligjit Nr.08/L-017. Neni 25 i Ligjit Nr.08/L-017, i obligon institucionet e administratës qendrore, agjencitë e pavarura, dhe autoritetet komunale që të hartojnë dhe aprovojnë Planet e Integritetit, jo më vonë se gjashtë muaj nga aprovimi i metodologjisë uniforme për hartimin e këtyre planeve.

Numri në total i Institucioneve përgjegjëse për miratimin e planeve të integritetit të identifikuar nga ana e Agjencisë për vitin raportues ka qenë 139.

Numri i Institucioneve që kanë caktuar personat përgjegjës për menaxhimin e përgatitjes dhe zbatimin të planit të integritetit pas kërkesës së Agjencisë, ka qenë 133 zyrtar përgjegjës.

Me përjashtim të 6 Institucioneve, përkundër informimit të vazhdueshëm nga Agjencia për këtë çështje, nuk kanë caktuar fare personat përgjegjës.

Institucionet publike që nuk i kanë caktuar personat përgjegjës janë:

1. Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë,
2. Komuna e Fushë Kosovës,
3. Komuna e Graçanicës,
4. Komuna e Leposaviqit,
5. Komuna e Shtërpcës,
6. Komuna e Zubin Potokut.

Institucionet publike të cilat nuk kanë miratuar Plane të Integritetit

Afati i fundit për miratimin e planeve të Integritetit ka qenë data 26.01.2024.

Në Agjenci janë përcjellë 120 Plane të Integritetit të miratuara nga ana e drejtuesve të institucioneve publike, ndërsa deri më sot nuk kanë dorëzuar fare plane integriteti, 19 institucione përgjegjëse për miratimin e tyre.

Nr.	Institucionet
1.	Agjencia për Investime dhe Perkrahejen e Ndërmarrjeve në Kosovë
2.	Agjencia e Kosovës për Akreditim
3.	Ansambli Kombëtar i Këngëve dhe Valleve “Shota”
4.	Filharmonia e Kosovës
5.	Inspektorati i Shëndetësië
6.	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
7.	Komuna e Shtimes
8.	Komuna e Fushë Kosovës
9.	Komuna e Gracanicës
10.	Komuna e Leposaviqit
11.	Komuna e Shtërpçës
12.	Komuna e Zubin Potokut
13.	Ministria e Mjedisit, Planifikimi Hapësinor të Infrastrukturrës
14.	Ministria e Mbrojtjes
15.	Qendra Kinematografike e Kosovës
16.	Universiteti “Fehmi Agani” në Gjakovë
17.	Universiteti “Hasan Prishtina” në Prishtinë
18.	Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë
19.	Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj

Tabela Nr. 15 Lista e institucioneve që nuk kanë përcjellë Planet e Integritetit

Nga 120 institucione publike që kanë hartuar Plane të Integritetit, 6 prej këtyre institucioneve nuk i kanë hartuar Planet e tyre në harmoni me Metodologjinë për Planet e Integritetit të miratuar nga Agjencia në vitin e kaluar.

Lista e institucioneve publike që nuk i kanë hartuar Planet e Integritetit sipas Metodologjisë së Planeve të Integritetit

Nr.	Institucionet
1.	Komuna e Prishtinës
2.	Komuna e Decanit
3.	Komuna e Junikut
4.	Komuna e Obiliqit
5.	Komuna e Skenderajit
6.	Komuna e Ranilugut

Tabela Nr. 16 Lista e institucioneve që nuk i kanë hartuar Planet e Integritetit

Raportimi dhe Monitorimi i Planeve të Integritetit për periudhën janar – qershor 2024

Agjencia ka plotësuar obligimin e saj ligjor, duke miratuar me datë 16.05.2024 Udhëzuesin për monitorimin dhe raportimin e Planit të Integritetit, i ndryshuar/plotësuar me datë 19.08.2024 i cili mund ta gjendet në linkun:

https://apk-rks.net/index.php/ova_doc/udhezuesi-per-monitorimin-dhe-raportimin-e-zbatimit-te-planit-te-integritetit/.

Udhëzuesi i miratuar nga ana e Agjencisë ka shërbyer si referencë për të ndihmuar të gjitha institucionet publike në monitorimin dhe raportimin e zbatimit të Planit të Integritetit.

Agjencia gjatë muajit maj dhe nëntor 2024, organizoj 5 sesione të trajnimeve informuese për mënyrën e monitorimit dhe raportimit të Planit të Integritetit dhe obligimeve që rrjedhin për zyrtarin përgjegjës nga Udhëzuesi për monitorim dhe raportim të Planeve të Integritetit dhe sfidat eventuale.

Trajnimet u mbajtën në datat 21, 28, 29, 30 maj 2024, si dhe me datë 26 nëntor 2024. Këto trajnime janë organizuar dhe mbajtë me përkrahjen e OSCE- Misionit në Kosovë.

Për periudhën janar- qershor 2024, 91 institucione publike kanë raportuar mbi ecurinë e zbatimit të Planeve të Integritetit, 1 institucion publik Këshilli Prokurorial i Kosovës ka raportuar jo në përputhje me Udhëzuesin për monitorim dhe raportim dhe pas vlerësimit paraprak nuk e kemi pranuar si raportim standard, ndërsa 29 institucione nuk kanë raportuar fare mbi ecurinë e zbatimit të Planeve të tyre të Integritetit.

Nga të dhënat në dispozicion në Agjenci, 82 institucione publike kanë raportuar brenda afatit ligjor, 1 jashtë mënyrës standarde të raportimit, ndërsa 8 institucione kanë raportuar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me Udhëzuesin për Monitorimin dhe Raportimin e Planeve të Integritetit.

Nr.	Institucionet
1.	Autoriteti i Konkurrencës
2.	Komuna e Gjilanit
3.	Ministria e Drejtësisë
4.	Qendra e Studentëve
5.	Univeristeti i Prizrenit
6.	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve,
7.	Komuna e Mitrovicës së Veriut
8.	Komuna e Gjakovës

Tabela Nr. 17 Lista e institucioneve të cilat kanë raportuar jashtë afatit kohor

Nr.	Institucionet
1.	Agjencia e Metrologjisë së Kosovës
2.	Agjencia e Punësimit në Republikën e Kosovës
3.	Agjencia për Shërbimet e Navigacionit Ajror
4.	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës
5.	Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar
6.	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
7.	Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve
8.	Agjencia për Krahasim dhe Verifikim të Pronës
9.	Fondi i Sigurimeve Shëndetësore
10.	Galeria Kombëtare e Kosovës
11.	Inspektorati Qendror i Punës
12.	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale

13.	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
14.	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
15.	Komuna e Decanit
16.	Komuna e Dragashit
17.	Komuna e Hanit të Elezit
18.	Komuna e Kamenicës
19.	Komuna e Kaçanikut
20.	Komuna e Malishevës
21.	Komuna e Parteshit
22.	Komuna e Pejës
23.	Komuna e Podujevës
24.	Komuna e Prishtinës
25.	Komuna Ranilugut
26.	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
27.	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
28.	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
29.	Universiteti “Kadri Zeka” në Gjiilan

Tabela Nr18. Lista e Institucioneve që nuk e kanë përcjell në Agjenci raportin gjashtë (6) muajor janar – qershor 2024

Lidhur me hartimin, raportimin mbi zbatimin dhe monitorimin e Planeve të Integritetit janë përgatit edhe raporte të veçanta.

BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET VENDORE

Gjatë periudhës raportuese, në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe në kuadër të bashkëpunimit me institucionet vendore, Agjencia ka realizuar bashkëpunime me të gjitha institucionet relevante për zbatimin e fushës së saj të veprimtarisë. Kjo ka përfshirë zhvillimin e takimeve të ndryshme, angazhimin në përgatitjen dhe plotësimin e legjislacionit primar dhe sekondar, si dhe realizimin e veprimeve të tjera të nevojshme për përmbushjen e kërkesave dhe nevojave të Agjencisë. Aktivitetet dhe përfaqësimet në nismat e bashkëpunimit dhe koordinimit të aktiviteteve me institucionet vendore të nivelit të lartë janë udhëhequr nga Drejtori i Agjencisë, si më poshtë:

- Drejtori i Agjencise prezantoi mandatin e Agjencisë në tryezën e organizuar nga NGO Aktiv, në Graçanicë. /18 janar 2024;
- Takim me Anëtarët e Komisionit për Legjislacion dhe përfaqësuesit e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave të Republikës së Shqipërisë./16 Shkurt 2024;
- Takim me Inspektoratin e Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave të Republikës së Shqipërisë në APK për nënshkrimin e memorandumit “Bashkëpunimi për parandalimin e Korrupsionit mes Kosovës dhe Shqipërisë”. /21 Shkurt 2024;
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit bashkë-udhëhoqi takimin e Grupit Punues Kundër-korrupsionit, pjesë e Këshillit Kombëtar për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut/26 Shkurt 2024;
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit mori pjesë në tryezën e diskutimit: Integriteti i sektorit privat; korrupsioni nga ana e ofertës, të organizuar nga Instituti Riinvest. /29 shkurt 2024;

- Drejtori i Agjencisë ka marrë pjesë në takimin e mbajtur në Ambasadën e Mbretërisë së Holandës në Kosovë/1 Mars 2024;
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit në Kosovë, e udhëhequr nga Drejtori Yll Buleshkaj, ka kontribuar aktivisht në Konferencën Ndërkombëtare të Nivelit të Lartë në Tiranë, me titullin "Forcimi i Përgjegjshmërisë: Fuqizimi i përpjekjeve kundër korrupsionit në Ballkanin Perëndimor"/5 Mars 2024;
- Në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori, Yll Buleshkaj, priti në takim Kryetarin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil, z. Arben Mehmeti, dhe Anëtarin e Këshillit, z. Jeton Koca/13 Mars 2024;
- Drejtori i Agjencisë ka marrë pjesë në tryezën e rrumbullakët me titull "Udhërrëfyese për Rritjen e Transparencës në Luftën kundër Korrupsionit" në Shtërpcë, e organizuar nga NGO Aktiv. / 22 Prill 2024;
- Drejtori i Agjencisë, Yll Buleshkaj, pati një takim me qytetarë aktiv të komunës së Leposaviqit. /22 Maj 2024;
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK) e Kosovës ka organizuar një takim konsultativ produktiv me organizatat e shoqërisë civile (OSHC) të specializuara në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit/23 Maj 2024;
- Drejtori i Agjencisë ka marrë pjesë në tryezën e rrumbullakët me titullin "Prezantimi i gjetjeve nga procesi i hartëzimit të rrezikut të korrupsionit. /7 Korrik 2024;
- Drejtori i Agjencisë morri pjesë në një takim me qytetarë dhe aktivistë për parandalimin e korrupsionit dhe transparencën në Ranillug, në të cilën drejtori i APK iu prezantoi pjesëmarrësve në tryezë mandatin e Agjencisë, bashkëpunimin me shoqëri civile dhe media, si dhe rëndësinë vendimtare të pjesëmarrjes së qytetarëve në parandalimin e korrupsionit. /16 Korrik 2024;
- Drejtori i Agjencisë morri pjesë në një takim me qytetarë dhe aktivistë për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit si dhe rritjen e transparencës në Mitrovicën e Veriut dhe Zveqan. / 23 Korrik 2024;
- Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit Yll Buleshkaj mori pjesë në takimin e organizuar nga Agjencia për Informim dhe Privatesi në Javën e Qasjes në Dokumente Publike. / 26 Shtator 2024;
- Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, Yll Buleshkaj, mori pjesë si panelist në eventin "PAR Kosova 2024" në panelin me temën: "Korrupsioni, Etika dhe Kultura në Administratën Publike"/26 Shtator 2024;
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit zhvilloi një takim me të rinjtë e Zubin Potokut, organizuar me ndihmën e OJQ Aktiv dhe mbështetjen e INL Kosovo./27 Shtator 2024;
- Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, z. Yll Buleshkaj, mbajti një takim produktiv me Guvernatorin e [Banka Qendrore e Republikës së Kosovës](#), z. Ahmet Ismaili, në zyrat e BQK-së./23 Tetor 2024;
- Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, Yll Buleshkaj, mori pjesë në takimin strategjik të organizuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë me përfitues dhe partnerë nga sektori i sigurisë, për të reflektuar mbi bashkëpunimin produktiv gjatë vitit 2024 dhe planifikimin për 2025./28 Tetor 2024;

- Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, Yll Buleshkaj, u takua me z. Artan Muratin, Menaxher i Lartë i Programit në Institutin Kombëtar Demokratik ([National Democratic Institute](#)) në Kosovë. / 1 Nentor 2024;
- Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit (APK), Yll Buleshkaj, zhvilloi një takim të frytshëm me përfaqësues të Fondit Monetar Ndërkombëtar ([International Monetary Fund](#)), përfshirë z. David Amaglobeli, Shef i Misionit të FMN-së për Kosovë; z. Javier Kapsoli, Ekonomist i Lartë në Departamentin Evropian; dhe z. Selim Thaçi, Ekonomist i Lartë në Zyrën e Përfaqësuesit të Përhershëm në Kosovë./1 Nentor 2024;
- Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, Yll Buleshkaj, priti përfaqësuesit e Rrjetit të Organizatave Joqeveritare AVONET në një takim të frytshëm. / 8 Nentor 2024;
- Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit , Yll Buleshkaj mirëpriti Ambasadorin Aivo Orav , Shef i Zyrës së BE-së në Kosovë dhe Përfaqësues Special i BE-së në një takim njoftues./19 Nentor 2024;
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit mori pjesë aktive në Konferencën Rajonale “Praktikat më të mira në Parandalimin e Korrupsionit”, e mbajtur në Prishtinë. Drejtori i APK-së, Yll Buleshkaj, ndau përvojat e Kosovës në ndërtimin e institucioneve të qëndrueshme dhe promovimin e transparencës./19 Nentor 2024;
- Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit , Yll Buleshkaj mori pjesë në takimin e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, ku Plani i Performancës për vitin 2025 i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit u shqyrtua dhe u miratua njëzëri. / 5 dhjetor 2024;
- Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, z. Yll Buleshkaj, mori pjesë në konferencën “Sinjalizimi: Një Shtyllë për Transparencën dhe Llogaridhënien”, organizuar nga iniciativa [CorrWatch](#), me mbështetjen e [British Embassy Pristina](#) në Kosovë./ 10 Dhjetor 2024;
- Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, z. Yll Buleshkaj, mori pjesë në tryezën e diskutimit të organizuar nga [Lëvizja FOL](#) , me temën “Sinjalizuesit nga Perspektiva Praktike”, në kuadër të Javës Kundër Korrupsionit. / 10 Dhjetor 2024;
- Drejtori Buleshkaj mori pjesë në mbledhjen e Këshillit për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut për veprime urgjente mbi shëndetin mendor./11 Dhjetor 2024;

BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE DHE INSTITUCIONE TË HUAJA

Bashkëpunimi ndërkombëtar është realizuar përmes përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së Drejtorit dhe stafit të Agjencisë në aktivitete të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit. Këto përfshijnë vizita ndërkombëtare dhe rajonale, si dhe pjesëmarrje në konferenca dhe ngjarje rajonale. Qëllimi kryesor i këtyre aktiviteteve ka qenë përfaqësimi i Agjencisë dhe shkëmbimi i praktikave më të mira për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.

- Përfaqësues të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit morën pjesë në Konferencën Rajonale "Evropa Juglindore së bashku kundër Korrupsionit: Zhvillimi i Rezistencës Rajonale" e organizuar në Sarajevë nga Iniciativa Rajonale Kundër-Korrupsion (RAI)./21 Shkurt 2024;

- Një delegacion i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit në Kosovë, i kryesuar nga drejtori Yll Buleshkaj, ka realizuar një vizitë studimore në Slloveni, përkatësisht në Komisionin për Parandalimin e Korrupsionit (KPK) në Lubjanë, me synim rritjen e bashkëpunimit dhe shkëmbimin e praktikave më të mira në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit./7 Mars 2024;
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit e Kosovës zhvilloi një vizitë të suksesshme në Transparency International në Slloveni. Në takim u debatuan tema si: bashkëpunimin në hartimin e Strategjisë kundër korrupsionit të Sllovenisë, monitorimin e planeve të integritetit, dhe raportin e shoqërisë civile me Komisionin për Parandalimin e Korrupsionit të Sllovenisë./8 Mars 2024;
- Përfaqësuesi i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit (APC), z. Bajram Lakna, mori pjesë në tryezën “Masat e integritetit dhe kontrollit në institucionet e mbrojtjes dhe të zbatimit të ligjit” e organizuar nga [RACVIAC-Centre for Security Cooperation](#) (Qendra për Bashkëpunim të Sigurisë) dhe [Regional Anti-Corruption Initiative - RAI](#) (Iniciativa Rajonale Kundër Korrupsionit) në Kroaci./27 Maj 2024;
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit në Kosovë, përfaqësuar nga Drejtori Buleshkaj, ishte pjesë e takimit të nivelit të lartë, në mesin e agjencive nga 30 vendeve të botës nga 5 kontinente, ku u diskutua rëndësia e parandalimit dhe luftimit të korrupsionit. Takimi u mbajt si pjesë e Konferencës Ndërkombëtare Kundër-Korrupsion, të mbajtur në Vilnius, Lituani. /21 Qershor 2024;
- Më 1-4 Korrik 2024, një delegacion nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK) e Kosovës, i udhëhequr nga Drejtori Yll Buleshkaj, realizoi një vizitë studimore në Republikën e Koresë. Gjatë kësaj vizite, delegacioni zhvilloi takime në Qendrën e Politikave të UNDP-së në Seul dhe në Komisionin për të Drejtat Civile dhe Anti-Korrupsion të Koresë (ACRC). /1-4 Korrik 2024;
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit mori pjesë në Takimin e 23-të Monitorues Plenar të Rrjetit Kundër Korrupsionit për Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore (ACN), si dhe në Takimin e 29-të të Grupit Drejtues të ACN-së në Paris, organizuar nga OECD./19 Shtator 2024;
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK) mori pjesë në takimin e 14-të të Rrjetit Kundër Korrupsionit të Agjencive të Zbatimit të Ligjit, organizuar nga OECD në Riga, Letoni./28 Tetor 2024;
- Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, z. Yll Buleshkaj, ka marrë pjesë në Takimin e 4-të të Grupit për Integritetin në Biznes të Rrjetit të OECD-së për Luftimin e Korrupsionit në Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore, në Paris./26 Nëntor 2024;
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit mori pjesë në Konferencën Vjetore dhe Asamblenë e Përgjithshme të [EPAC and EACN](#), të mbajtur në Bukuresht, Rumania. Në këtë event të rëndësishëm, Agjencia jonë u bë anëtare e 120-të e rrjetit më të madh të Agjencive kundër korrupsionit dhe institucioneve për mbikëqyrje policore në Evropë./ 27 Nëntor 2024;

BASHKËPUNIMI RAJONAL

- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit në Kosovë, e udhëhequr nga Drejtori Yll Buleshkaj, ka kontribuar aktivisht në Konferencën Ndërkombëtare të Nivelit të Lartë në Tiranë, me titullin "Forcimi i Përgjegjshmërisë: Fuqizimi i përpjekjeve kundër korrupsionit në Ballkanin Perëndimor"./5 Mars 2024;
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit mori pjesë në konferencën rajonale në Tiranë që diskutoi pastrimin e parave dhe korrupsionin e lidhur me krimin mjedisor në Ballkanin Perëndimor/7-8 Mars 2024;
- Drejtor i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, mbajti një fjalim në Forumin Rajonal me temën Kundër Korrupsioni dhe Kapja e Shtetit – Përparimi drejt Anëtarësimit në BE i Vendeve të Ballkanit Perëndimor, organizuar nga SELDI dhe Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike (ACER), të mbajtur në Tiranë./3 Tetor 2024;
- Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit (APK), z. Yll Buleshkaj, mori pjesë aktive në Konferencën Anti-Korrupsion për Ballkanin Perëndimor, e mbajtur në Shkup. Gjatë konferencës, ai ndau te arriturat e APK-së në promovimin e transparencës dhe luftën kundër korrupsionit./22 Nëntor 2024;
- Drejtori i Departamentit për Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, z. Afrim Atashi, ka marrë pjesë në konferencën "Takimi Rajonal për Politikën e Rikuperimit të Pasurisë," që po zhvillohet në Budva, Mal të Zi./26 Nëntor 2024.

AKTIVITETET MEDIATIKE

Si rezultat i përmbushjes së qëllimit për të realizuar mandatin e saj me transparencë dhe llogaridhënie, Agjencia ka rritur maksimalisht numrin e veprimeve konkrete duke bashkëpunuar me të gjithë akterët relevant për parandalimin e korrupsionit në Kosovë dhe në periudhën raportuese janar-dhjetor 2024 ka realizuar një numër të konsiderueshëm të aktiviteteve mediale, të vetëdijesimit të publikut të gjerë.

Aktivitetet mediale të Agjencisë gjatë vitit 2024 u fokusuan në komunikimin me media, organizmit të konferencave, intervistat për media dhe bashkëpunimin me mediat në inicimin e trajtimit të rasteve për parandalim të konfliktit të interesit, procedurat e hetimeve administrative dhe dyshime për deklarim jo-të saktë të pasurisë si dhe nëpërmjet publikimit pro-aktiv të informatave në ueb-faqen e APK-së. Në vitin 2024 Agjencia organizoi:

- Konferenca për media – si lansimi i platformës për raportim të keqpërdorimeve në dhjetor 2024;
- Konferencë për prezantimin e rezultateve të procesit të hartëzimit të korrupsionit përkrahur nga Këshilli i Evropës;

- Fushata informuese për mandatin e APK-së që u transmetuan në televizionin publik dhe rrjete sociale;
- Në kuadër të informimit dhe llogaridhënies publike dhe përgjigjeve në kërkesat e gazetareve gjatë vitit 2024, u realizuan gjithsej 47 intervista apo prononcime;
- Nga 54 përgjigje të ofruara për mediat në vitin 2021, dhe 165 përgjigje në vitin 2022, në periudhën raportuese janar-dhjetor 2023, Agjencia ofroi përgjigje për rreth 145 pyetje të pranuar nga mediat, ndërsa gjatë vitit 2024 rreth 140 përgjigje;

AKTIVITETET E VETËDIJËSIMIT TË PUBLIKUT

Me qëllim të informimit të zyrtarëve publik lidhur me respektimin e obligimeve të përcaktuara për deklarimin e pasurisë, Agjencia ka përgatitur 3 spote televizive: 1) Thirrje për deklarim te pasurisë, 2) Thirrje për raportim te korrupsionit dhe bashkëpunim institucional; 3) Mandati i APK. Këto janë transmetuar në Radio Televizionin Publik të Kosovës (RTK).

Si rezultat i bashkëpunimit me Organizatat Jo-Qeveritare, mbështetur nga Ambasada Amerikane në Prishtinë, Drejtori i Agjencisë sipas Marrëveshje të Bashkëpunimit mes Agjencisë me Organizatën Jo-Qeveritare AKTIV, ka zhvilluar shtatë aktivitete vetëdijësuese me qytetar të komuniteteve jo-shumicë për qëllim vetëdijesimin e publikut në lidhje me raportimin e korrupsionit pas lansimit të aplikacionit mobil të veçantë për raportim të korrupsionit – ABER, në komunat: Gracanicë, Ranillug, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok, dhe Leposaviç.

KËRKESAT PËR QASJE NË INFORMATA PUBLIKE

Gjatë periudhës raportuese, Agjencia pranoi 21 kërkesa për qasje në dokumente publike, të cilat u trajtuan konform Ligjit. Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike.

Nga gjithsej 21 kërkesa, për 16 nga kërkesat u ofrua qasje e plotë në informacion, në 3 nga kërkesat u ofrua qasje e pjesshme në informacion ndërsa për 2 nga kërkesat bazuar në dispozitat ligjore të legjislacionit në fuqi u refuzua qasja në informacion.

Trajtimi i kërkesave për Qasje në dokumente publike janar- dhjetor 2024
21 kërkesa të pranuar
16 qasje e plotë në informacion,
3 qasje e pjesshme në informacion
2 të refuzuara

Profili i subjekteve që kërkuan qasje në dokumente publike: 3 kërkesa u pranuan nga mediat, 13 kërkesa u pranuan nga Organizata Jo-Qeveritare, 4 kërkesa nga persona privat, dhe 1 kërkesë u pranua nga të tjerë. Ndërsa natyra e kërkesave për qasje ishte si në vijim:

1. Dokumente administrative- 10
2. Dokumente ligjore dhe nën ligjore- 1
3. Statistika- 8
4. Të tjera-2

JAVA E INTEGRITETIT 2024

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK) organizoi me sukses "Javën e Integritetit 2024", një iniciativë e dedikuar forcimit të transparencës, llogaridhënies dhe ndërtimit të institucioneve me integritet. Kjo javë e aktiviteteve, e zhvilluar nga 9 deri më 13 dhjetor 2024, mbledhi mbi 300 pjesëmarrës nga institucione publike, sektori privat, shoqëria civile dhe media, duke kontribuar në debatin mbi praktikën e mira për luftën kundër korrupsionit.

Gjatë pesë ditëve të aktiviteteve, u mbajtën tryeza diskutimi me tema të ndryshme, duke përfshirë integritetin institucional, parandalimin e konfliktit të interesit, rolin e sinjalizimit, transparencën e zyrtarëve publik dhe sfidat e prokurimit publik.

Çdo ditë e kësaj jave u mbulua gjerësisht nga mediat vizive dhe të shkruara, duke reflektuar interesimin dhe rëndësinë e temave të trajtuara.

Dita e Parë: Integriteti Institucional dhe Politikat Kundër Korrupsionit

Ngjarja hapëse e "Javës së Integritetit 2024" u mbajt më 9 dhjetor, në Ditën Ndërkombëtare Kundër Korrupsionit. Kjo tryezë diskutimi u fokusua në rolin e integritetit institucional, zbatimin e planeve të integritetit dhe politikën kundër korrupsionit.

Drejtori i APK-së, z. Yll Buleshkaj, theksoi se transparenca dhe llogaridhënia janë elementë kyç për forcimin e besimit në institucione. Po ashtu, u lansua aplikacioni i ri për raportimin e korrupsionit, duke krijuar një platformë për raportim 24/7 të shkeljeve.

Dita e Dytë: Transparenca përmes Deklarimit të Pasurisë dhe Dhuratave

Më 10 dhjetor, u mbajt diskutimi mbi rëndësinë e transparencës së zyrtarëve publikë përmes deklaramit të pasurisë dhe dhuratave. Ku u theksua se ky mekanizëm nuk është vetëm një detyrim ligjor, por një instrument thelbësor për ndërtimin e integritetit. Në përfundim të ngjarjes, znj. Arta Kotorri nga ZKM u nderua me Çmimin për Personin Kontaktues të Dalluar.

Dita e Tretë: Parandalimi i Konfliktit të Interesit

Më 11 dhjetor, APK organizoi tryezën me temën "Parandalimi i Konfliktit të Interesit: Parakusht për Besim në Institucione". Panelistët ndanë praktikën më të mira për shmangien e konfliktit të interesit dhe diskutuan mbi sfidat e zbatimit të rregulloreve në fushën e administratës publike. Çmimi për Autoritetin Përgjegjës të Dalluar iu nda znj. Albulena Stublla-Krasniqi nga Administrata Tatimore e Kosovës.

Dita e Katërt: Roli i Sinjalizimit në Sektorin Publik dhe Privat

Më 12 dhjetor, u organizua tryeza e diskutimit mbi rolin e sinjalizimit në sektorin publik dhe privat. Pjesëmarrësit diskutuan mbi sfidat dhe praktikat më të mira për mbrojtjen e sinjalizuesve. Për kontributin e saj të jashtëzakonshëm, znj. Fatmire Shala Kastrati nga Instituti i Mjekësisë Ligjore u nderua me mirënjohje.

Dita e Pestë: Prokurimi Publik – Integritet dhe Transparencë

Më 13 dhjetor, APK dhe Komisioni Rregullativ për Prokurimin Publik (KRPP) organizuan një tryezë me temën "Prokurimi Publik – Mundësi dhe Rrezik". Diskutimi u fokusua në sfidat e prokurimit publik, mekanizmat për rritjen e transparencës dhe parandalimin e shkeljeve. Drejtori i APK-së, z. Yll Buleshkaj, theksoi nevojën për bashkëpunim ndër-institucional për forcimin e integritetit.

Java e Integritetit 2024 u bë një platformë e suksesshme për debat dhe bashkëpunim për forcimin e transparencës dhe integritetit në institucione. Aktivitetet e mbajtura reflektuan angazhimin e APK-së dhe partnerëve të saj në Parandalimin e korrupsionit dhe promovimin e qeverisjes së mirë.

Me pjesëmarrje të gjerë dhe diskutime të frytshme, ky organizim vendosi bazat për avancimin e politikave të integritetit në Kosovë.







TRAJTIMI I RASTEVE TË SINJALIZIMIT TË JASHTËM

Në bazë të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-085 Për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, përcaktohet e drejta e sinjalizuesve për të bërë sinjalizim të jashtëm pasi kanë kryer sinjalizimin e brendshëm, apo edhe drejtpërdrejtë sinjalizim të jashtëm. Procedura për sinjalizim të jashtëm për sektorin publik iniciohet me raportimin e informacionit tek Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit.

Gjatë vitit 2024 Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, ka pranuar dhe trajtuar gjithsej 48 raportime, gjatë kësaj periudhe pretendimet e paraqitura janë trajtuar me kohë dhe nuk është bartur asnjë rast për vitin pasues, epilogu i rasteve është si në vijim:

23 raste janë proceduar dhe deleguar në organet kompetente, pesë 5 prej tyre janë përcjellë në Gjykatën për Kundërvajtje, 3 raste në Prokurorinë e Shtetit, 6 raste në Policinë e Kosovës, ndërsa 9 raste janë dërguar në institucionet tjera kompetente.

Rastet e përcjella në Gjykatën për Kundërvajtje, në 2 raste kur raportet e sinjalizuesve nuk janë pranuar dhe trajtuar sipas detyrimeve ligjore, dy për shkak se janë marrë masa kundër sinjalizuesve, në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, si dhe në një rast kur institucioni përkatës nuk ka përmbyshur detyrimin ligjor për të caktuar Zyrtarin Përgjegjës.

Rastet e përcjella në Prokurorinë e Shtetit, 3 raste janë përcjellë si Informata për shkak të dyshimit të arsyeshëm që ka pasur elemente të veprave penale dhe të njëjtën kohë për të vlerësuar nëse ekzistojnë prova të mjaftueshme apo duhet të sigurohen prova tjera, në mënyrë që të vazhdohen procedurat tjera të mëtejshme ligjore.

Rastet e përcjella në Policinë e Kosovës, Departamenti për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsion, 6 raste janë përcjellë në Policinë e Kosovës, për të vlerësuar nëse duhet të fillojë ndonjë hetim eventual penal apo duhet të sigurohen prova tjera për të proceduar më tutje.

Rastet e përcjella në Institucionet Publike, 9 raste janë dërguar te Institucionet tjera publike të konstatuara si kompetente nga ana e Agjencise si: 2 në Doganat e Kosovës, 1 në Ministrinë e Drejtësisë, 3 në Ministrinë e Punëve të Brendshme, 1 në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, 1 në Komunën e Prishtinës, dhe 1 në Byronë Kosovare të Sigurimit, prej të cilave është kërkuar që të vlerësojnë pretendimet e paraqitura dhe të ndërmarrin masa për to.

Rastet e mbyllura dhe refuzuara: 9 raste rezultojnë të jenë mbyllur në vitin 2024, pasi që pas zhvillimit të procedurës së hetimit administrativ dhe provave të shqyrtuara, nuk janë vërtetuar pretendimet e paraqitura nga ana e sinjalizuesve. Kryesisht këto raste kanë qenë me pretendime të mangëta, të cilat nuk kanë pasur ndonjë provë bindëse dhe të arsyeshme. Ndërsa 16 raste janë refuzuar, me arsyetimin se nuk i kanë plotësuar kushtet e parapara me Ligjin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, për tu trajtuar si Sinjalizim i Jashtëm nga ana e Agjencisë.

Këto raste me gjithë faktin që Agjencia ka tentuar nga vet sinjalizuesit potencial, që ti plotësojnë pretendimet e paraqitura karshi Ligjit të lartcekur (LMS), janë refuzuar pasi që nuk kanë kthyer përgjigje më ose nuk kanë shfaqur asnjë interes për të vazhduar më tutje. Gjithashtu në shumicën e këtyre rasteve ka munguar elementi i interesit publik.

TRAJTIMI I RASTEVE TË SINJALIZIMIT TË BRENDSHËM

Punëdhënësi publik i cili ka më shumë se pesëmbëdhjetë (15) të punësuar, dhe punëdhënësi privat, i cili ka më shumë se pesëdhjetë (50) të punësuar janë të obliguar të caktojnë zyrtarin përgjegjës. Në kuptim të kësaj gjatë vitit 2024, nga **195** Institucione publike për të cilat Agjencia ka të dhëna se kanë caktuar Zyrtarin Përgjegjës, raportin në Agjenci e kanë përcjellë **184** Institucione, derisa **11** Institucione nuk e kanë dërguar këtë raport fare.

Sa i përket subjekteve private janë gjithsej 11 subjekte të cilat kanë raportuar lidhur me rastet e sinjalizimit për vitin 2024.

Gjatë vitit 2024, janë dalluar tre institucione me numrin më të madh të raportimeve të sinjalizimit, të cilat janë: Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar, Korporata Elektroenergjetike e Kosovës dhe Shërbimi Korrektues i Kosovës.




Figura 6. Paraqitja grafike e institucioneve me numrin më të madh të sinjalizimeve gjatë vitit 2024

AKTIVITETE/TRAJNIME ME ZYRTARË PËRGJEGJËS

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK) është e përkushtuar të mbajë trajnime dhe aktivitete edukative për zyrtarët përgjegjës në fushën e sinjalizimit, duke siguruar që ata të jenë të informuar dhe të aftë për të zbatuar politikën e mbrojtjes së sinjalizuesve në institucionet përkatëse.

Trajnimet janë një pjesë e rëndësishme e angazhimit të APK-së për të përmirësuar njohuritë dhe aftësitë e zyrtarëve përgjegjës për menaxhimin e rasteve të sinjalizimit, duke i mundësuar atyre të veprojnë në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Këto trajnimet përfshijnë:

- Kuptimi i Ligjit dhe Procedurave të Sinjalizimit: Trajnimi i zyrtarëve për rregullat dhe procedurat që duhet ndjekur kur merren me sinjalizimet, si dhe për mënyrën e trajtimit të rasteve të sinjalizuesve.
- Trajtimi i Rasteve të Sinjalizimit: Zhvillimi i aftësive për të vlerësuar dhe hetuar rastet e sinjalizimit, duke siguruar që procesi të jetë i drejtë me sinjalizuesit.
- Rëndësia e Transparencës dhe Llogaridhënies: Trajnimi i zyrtarëve për rëndësinë e transparencës në administratën publike dhe për ndikimin që ka sinjalizimi në parandalimin e korrupsionit dhe përmirësimin e shërbimeve publike.
- Edukimi për Menaxhimin e Informacioneve Konfidenciale: Përdorimi i teknologjive dhe metodave për të siguruar që informacionet e sinjalizuara të mbeten të sigurta dhe konfidenciale, duke mbrojtur identitetin e sinjalizuesve.
- Sigurimi i Mbrojtjes për Sinjalizuesit: Edukimi i zyrtarëve mbi mënyrën e sigurisë dhe mbrojtjes së sinjalizuesve nga hakmarrjet dhe ndëshkimet e mundshme që mund të vijnë pas një sinjalizimi.

Gjatë vitit 2024, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK), ka mbajtur gjithsej dhjetë (10) aktivitete, të gjitha për zyrtarët përgjegjës të Institucioneve publike, në disa nga këto aktivitete Agjencia është mbështetur nga OSCE-Misioni në Kosovë, të cilat janë realizuar gjatë gjithë vitit: dy në muajin maj, dy në muajin qershor, dy në muajin tetor, tre në nëntor dhe një në dhjetor.

Përmes këtyre trajnimeve, APK synon të krijojë një mjedis më të sigurt për sinjalizimin, që do të ndihmojë në parandalimin e korrupsionit dhe do të promovojë institucione më të përgjegjshme dhe më transparente.

Disa foto nga aktivitetet





MËSIMET E NXJERRA DHE PRIORITETET NË TË ARDHMEN

Menaxhmenti i Agjencisë edhe gjatë vitit 2024 ka vazhduar fokusin e saj në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies institucionale duke garantuar paanshmëri dhe trajtim të barabartë gjatë ushtrimit të fushë veprimtarisë së vet. Ky angazhim ka ndikuar në rritjen e besimit të opinionit në Agjenci, dhe se numri i raportimeve të shumta të pranuar nga Agjencia, për deklarim të pasaktë të pasurisë, për konflikt të mundshëm të interesit apo raportimeve për shkelje tjera të cenimit të interesit publik, nga qytetarë, grupe të ndryshme të interesit, institucione, dhe zyrtarët më të lartë të shtetit, tregon për ngritjen e nivelit të vetëdijes së qytetarëve për të raportuar cdo shkelje dhe gatishmërinë e tyre për të kontribuar në luftën kundër korrupsionit.

Sensibilizimi i zyrtarëve publik në fushën e parandalimit të konfliktit të interesit ka qenë fokus gjatë vitit 2024. Numri i madh i kërkesave për trajtimin e situatave të konfliktit të interesit, tregon rritjen e besimit në punën e Agjencisë. Hezitimi i autoriteteve përgjegjëse për të trajtuar situatat e konfliktit të interesit, tregon mungesën e angazhimit nga institucionet përkatësisht udhëheqësit të zbatojnë dhe monitorojnë procedurat brenda institucioneve lidhur me konfliktin e interesit. Pavarësisht fushatave sensibilizuese dhe trajnimeve të vazhdueshme, qëllim i Agjencisë mbetet ngritja e nivelit të standardit të përgjegjësisë dhe llogaridhënies së zyrtarëve publik që vet ata të trajtojnë konfliktin e interesit gjatë procesit të vendimmarrjes dhe ushtrimit të funksionit zyrtar dhe me iniciativat vetanake t'i shmangin situatat e mundshme të konfliktit të interesit, pa pasur nevojë për ndërhyrjen e Agjencisë.

Procesi i sistematizimit dhe riorganizimit të brendshëm të Agjencisë konform mandatit dhe kompetencave ligjore, ka mundësuar shpërndarjen efikase të burimeve njerëzore dhe ka ndihmuar dukshëm në një menaxhim më të mirë të detyrave dhe përgjegjësisve ligjore të Agjencisë. Prioritet në vazhdim mbetet ngritja e kapaciteteve profesionale, prandaj aprovimi i pozitave shtesë do të ndihmonte në masë të madhe përmirësimin e efikasitetit të punës së Agjencisë, duke evituar të gjitha problemet apo sfidat me të cilat Agjencia ballafaqohet për shkak të mungesës së stafit të mjaftueshëm në sektorë të caktuar të Agjencisë.

Aplikimi i sistemit të deklarimit të pasurisë dhe dorëzimit elektronik ka duke vazhduar në rritjen e transparencës dhe saktësisë së monitorimit dhe verifikimit të pasurisë së deklaruar. Përmirësimi dhe transformimi digjital i Agjencisë gjatë vitit 2024, ka qenë një hap i rëndësishëm i cili ka ndikuar në efikasitetin dhe transparencën e punës së Agjencisë përmes sistemeve të ndryshme si dhe platformave të cilat kanë lehtësuar procesin e deklarimit të pasurisë dhe menaxhimin e të dhënave nga zyrtarët, si dhe qasjen më të lehtë për qytetarët në përdorimin e shërbimeve elektronike në raste të denoncimit të situatave/rasteve në Agjenci. Prioritet i Agjencisë në vazhdim në fushën e digjitalizimit është integrimi i sistemeve me sistemet/platformat e tjera të institucioneve shtetërore, si mundësi shumë efektive për grumbullimin e të dhënave nga shumë burime si dhe krijimin e analizave më të detajuara dhe të bazuara në të dhëna konkrete për të identifikuar shkeljet e mundshme në fusha të caktuara, e cila do të mundësonte poashtu një kontrollë të shpejtë dhe të saktë të informacionit.

Agjencia gjatë gjithë kohës në mënyrë intenzive ka punuar dhe vepruar në drejtim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies, duke qenë e hapur dhe e përgjegjshme në raport me informimin e publikut dhe institucioneve rreth punës dhe fushëveprimit të saj. Bashkëpunimi i Agjencisë me të gjithë akterët relevantë, institucionet shtetërore organizatat joqeveritare dhe mediat tregon transparencën dhe llogaridhënien e Agjencisë në raport me punën e saj. Publikimi i vazhdueshëm i aktiviteteve të Agjencisë, pjesëmarrjen e saj në media, konferenca, intervista të ndryshme, publikimin e vazhdueshëm të informacioneve me interes në faqen zyrtare të Agjencisë, kanë kontribuar në rritjen e vetëdijes dhe informimin e publikut, duke treguar angazhimin dhe përkushtimin e saj për të qenë e hapur dhe e përgjegjshme ndaj publikut.

Prioritet i saj në vazhdim mbetet organizimi i aktiviteteve në aspekt të vetdijësimit të qytetarëve për korrupsionin dhe ndikimin e tij në shoqëri, përmes formave të ndryshme të informimit dhe komunikimit me qytetarët, media sociale, fushata të ndryshme edukative, pjesëmarrje në emisione televizive etj. Pra përmirësimi i komunikimit me mediat dhe publikun është një prioritet shumë me rëndësi, pasi kjo ndihmon në rritjen e transparencës dhe besimin e qytetarëve dhe të opinionit publik në përgjithësi për punën e Agjencisë dhe rezultatet në raport me punën që bën Agjencia.

Përmirësimi dhe hartimi i vazhdueshëm i rregullave sipas standardeve ligjore është një element shumë i rëndësishëm të cilën Agjencia e ka zbatuar gjatë gjithë kohës, duke miratuar akte të ndryshme nënligjore në kuptim të zbatimit të plotë të mandatit të saj ligjor. Aktet nënligjore të miratuara gjatë vitit 2024 kanë ndihmuar punën e Agjencisë në krijimin dhe strukturimin e një baze të fortë të zbatimit të legjislacionit. Prioritet në vazhdim mbetet përditësimi i legjislacionit sekondar me atë primar, duke iu përshtatur nevojave dhe kërkesave të vazhdueshme institucionale, e cila është nevojë esenciale për mbarëvajtjen efikase të proceseve të punës si dhe përmbushjes së plotë të misionit që ka Agjencia drejtë parandalimit të korrupsionit.

Rritja e numrit të raportimeve të sinjalizimit gjatë vitit 2024, tregon rritjen e besimit në mekanizmin e sinjalizimit. Këtu kanë ndikuar edhe trajnimet e zyrtarëve përgjegjës brenda institucioneve të cilat kanë kontribuar edhe në përmirësimin e performancës si dhe në ngritjen e përgjegjësisë dhe përgjegjshmërisë në raport me sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Prioritet në vazhdim mbetet përforsimi i kapaciteteve profesionale për trajtimin e rasteve të sinjalizimit brenda institucioneve. Është shumë me rëndësi krijimi i një ambienti të sigurt dhe mbrojtës për sinjalizuesit për të inkurajuar raportimin e shkeljeve me interes publik, dhe të kuptohet se mbrojtja e tyre është një mekanizëm parandalues i korrupsionit që kontribuon në forcimin e përgjithshëm të integritetit në institucionet e sektorit publik dhe atij privat.


Agjencia synon që përmes forcimit të ekspertizës profesionale dhe shtimit të kapaciteteve të saj, përmes vlerësimit të rrezikut të korrupsionit në sektorë të ndryshëm, evitimit të zbrazëtirave në legjislacion që mundësojnë korrupsionin dhe monitorimin e planeve të integritetit të kontribuoj fuqishëm në parandalimin e korrupsionit në Kosovë.

Kërkesat dhe nevojat e identifikuara nga Agjencia gjatë realizimit të planit vjetor të performancës së Agjencisë për vitin 2024, janë mbështetur e përkrahur nga partnerët e ndryshëm përmes projekteve. Forcimi i bashkëpunimit me ata që mbështesin punën e Agjencisë, synohet të vazhdohet edhe më tutje.

Gjatë vitit 2024 ka pasur një bashkëpunim dhe bashkërendim të suksesshëm të aktiviteteve të saj me partnerë të ndryshëm ndërkombëtar. Ka kontribuar në aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë vendit të cilat kanë ndikuar edhe në rëndësinë e krijimit dhe të lidhjeve dhe bashkëpunimit me rrjete ndërkombëtare kundër korrupsionit. Kjo ka ndihmuar Agjencinë të marrë praktikën më të mira për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, duke i implementuar disa prej tyre edhe në punën e saj. Prandaj, duke parë rëndësinë e bashkëpunimit dhe të mbështetjes nga partnerët ndërkombëtarë të cilën Agjencia e ka shfrytëzuar në realizimin e objektivave të saj, prioritet në vazhdim i Agjencisë do të jetë përfaqësimi i saj në aktivitete ndërkombëtare, si dhe forcimi i bashkëpunimit rajonal dhe global me agjenci homologe dhe organizata të ndryshme ndërkombëtare.

Prioritet me rëndësi të vecantë mbetet angazhimi i të gjitha institucioneve përgjegjëse të veprojnë në drejtim të fuqizimit të autoriteteve përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesit, zyrtarëve kontaktues për deklarimin e pasurisë dhe dhuratave si dhe zyrtarëve përgjegjës brenda institucioneve për mbrojtjen e sinjalizuesve, si dhe krijimit të kushteve adekuate të punës për ta, si pika kontakti dhe koordinuese me Agjencinë, lidhur me përgjegjësitë e caktuara ligjore që kanë në aspekt të parandalimit të konfliktit të interesit, deklarimit të pasurisë dhe dhuratave si dhe sinjalizimit.

SHTOJCA NR. 1. ORGANOGRAMI I AGJENCISË PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT (APK)



SHTOJCA NR.2. LISTA E PJESËMARRJES NË TRAJNIME, FORUME, SEMINARE GJATË VITIT 2024

Nr.	Lloji i Trajnimit	Organizon	Vendi	Data	Nr. Pjesëmarrësve
1.	Metodologjia e vlerësimit lidhur me procesin e ristrukturimit me qëllim transferimin/sistemimin e vendeve të punës në APK	APK	Tiranë	07-10.02.2024	4
2.	Konferenca “Evropa Juglindore-së bashku kundër Korrupsionit”	RAI	Sarajevë	19-21.02.2024	2
3.	Trajnimi i avancuar për forcimin e integritetit institucional	OSBE	Prishtinë	26-27.02.2024	6
4.	Sistemin e Menaxhimit dhe Arkivimit Elektronik të Dokumenteve (SMAED)	MPB	Prishtinë	28.02.2024	1
5.		OSBE	Lubjanë	06-09.03.2024	5
6.	Korrupsioni dhe Pastrimi i Parave i shoqëruar me krim ambiental	Këshilli Evropës	Tiranë	07-08.03.2024	1
7.	Procesin analitik të Policisë së Udhëhequr nga Inteligjenca (PUI) për hetimet financiare të integruara në luftimin e krimit të organizuar	OSBE	Prishtinë	18-19.03.2024	5
8.	Punëtori për Hartimin dhe Finalizimin e legjislacionit që rrjedhë nga Deklarata e përbashkët e Zotimit	MD	Pejë	19-22.03.2024	1
9.		OSBE	Prizren	24-26.04.2024	12
10.	Hetimin e aseteve virtuale, duke përfshirë praktikën e gjurmimit dhe analizës së krimeve të lidhura me transaksionet e kriptomonedhave	OSBE	Prishtinë	07-08.05.2024	3
11.	Mbështetjen e ekspertëve në sekuestrimin, ngrirjen dhe konfiskimin e krimeve të lidhura me asetet virtuale	OSBE	Prishtinë	10.05.2024	5
12.	Sinjalizimi	GIZ	Prishtinë	13-14.05.2024	10
13.	Monitorimi i Planeve të Integritetit	GIZ	Prishtinë	15-16.05.2024	10
14.	Integriteti dhe Masat e Kontrollit në Institucionet e Mbrojtjes dhe të Zbatimit të Ligjit	RACVIAC/RAI	Zagreb	19-22.05.2024	1
15.	Trajnim për hetime të fshehta në lidhje me keqpërdorimin e pozitës zyrtare	OSBE	Prishtinë	20-21.05.2024	5
16.	Trajnimin për trajnerë mbi hetimet financiare	OSBE	Prishtinë	22-23.05.2024	6
17.	Hartimi i draft rregullore për Punë të APK-së si dhe Kodi i Mirësjelljes për Zyrtarët e AKP-së	APK	Tiranë	11-13.06.2024	8
18.	Konferenca Ndërkombëtare kundër Korrupsionit	Ambasada SHBA	Vilnius	17-22.06.2024	1

19.	Konferenca Ndërkombëtare kundër Korrupsioni	UNDP	Vilnius	17-22.06.2024	1
20.	Zbatimi i shpejtë i Konventës të Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsion Platforma Rajonale për Ballkanin Perëndimor	UNODC	Tiranë	25-27.06.2024	2
21.	Vizitë Studimore	UNDP	Seul	30.06-04.07.2024	4
22.	TpT Për Sistemin e Hartimit të Legjislacionit LDS	Prishtinë	IKAP	10-17.07.2024	1
23.	Vlerësimi I Korrupsionit në Legjislacion	Istog	SAEK III UNDP	29-31.07.2024	12
24.	Takimi Monitorues i 23-të dhe Mbledhja e 29 e Grupit Drejtues	Paris	OECD	16-19.09.2024	2
25.	Punëtori për planifikimin e Agjendës së Reformave në kuadër të Instrumentit të BE-së për reforma dhe Rritje Ekonomike për Ballkanin Perëndimor	Brezovicë	Zyra e Kryeministrit	26-27.09.2024	1
26.	Kundër Korrupsioni dhe kapja e shtetit- Progresi drejtë anëtarësimit në Bashkimin Evropian të vendeve të Ballkanit perëndimor	Tiranë	Lideri i Evropës Juglindore për Zhvillim dhe Integritet (SELDI)	03.10.2024	1
27.	Programi për Zhvillim të Ligjit Tregtar	Paris	SHBA	14-15.10.2024	1
28.	Pjesë e grupit Punues për Integritet Publik dhe kundër Korrupsionit	Paris	OECD	15-16.10.2024	1
29.	Përditësimi i Planit të Integritetit	Prizren	APK	16-18.10.2024	13
30.	Rritja e Zbatimit të ligjit kundër Korrupsionit për Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore (ACN LEN)	Riga	OECD	23-25.10.2024	2
31.	Plani Vjetor i Përformancës së APK-së për vitin 2025	Tiranë	APK		12
32.	Raporto Korrupsionin	Istog	SAEK III UNDP	11-13.11.2024	10
33.	Konferencë Vjetore Profesionale dhe Asamblesë së Përgjithshme	Bukuresht	EACN	26-27.11.2024	2
34.	Rritja e Zbatimit të ligjit kundër Korrupsionit për Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore (ACN LEN)	Paris	OECD	25-26.11.2024	1
35.	Hartimi i Rregullore për Procedurën e verifikimit dhe kontrollit të deklarimit të pasurisë	Tiranë	APK	13-16.12.2024	10
36.	Vizitë Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave në Shqipëri	Tiranë	APK	17-19.12.2024	4

Lista e subjekteve deklaruese që nuk kanë respektuar afatin e deklarimit të rregullt vjetor të pasurisë DRV

Nr.	Emri	Mbiemri	Institucioni	Funksioni
1	Besa	Morina Gega	Zyra Kombëtare e Auditimit	Auditor Senior
2	Ramiz	Krasniqi	Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit	Drejtor i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme
3	Jasmina	Stanojević	Administrata Tatimore e Kosovës	Zyrtar i mesëm i mbledhjes së etyrueshme
4	Miradije	Gashi	Dogana e Kosovës	Oficer i Lartë Doganor
5	Meleqe	Toçani	Policia e Kosovës	Zyrtar për Analizë të Krimeve ekonomike dhe Financiare
6	Shaqir	Brahimi	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike	Mjek Specialist Epidemiolog
7	Fikret	Lutfiu	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës	Inspektor i Veterinarisë
8	Selviqe	Blakaj-Gashi	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	Zëvendës, Udhëheqëse e Divizionit
9	Habib	Shehu	Komuna e Rahovecit	Anëtar i bordit Stacioni i autobusëve
10	Lule	Ballata	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	Kryetare e Këshillit Drejtues
11	Dukagjin	Krasniqi	Policia e Kosovës	Hetues
12	Reshadije	Nuredini	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	zv. Zyrtare certifikuese
13	Melihate	Godanci- Haxhiu	Administrata Tatimore e Kosovës	Auditor i Brendshëm
14	Perparim	Tabaku	Dogana e Kosovës	Udhëheqës ndërrimi
15	Velvetie	Zogaj	Policia e Kosovës	Hetues
16	Elmaze	Muharremi	Universiteti "Isa Boletini" Mitrovicë	Udhëheqës i Prokurimit
17	Ardiana	Krrabaj	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	Drejtor i Drejtorisë
18	Sahit	Hoti	Policia e Kosovës	Komandant i Stacionit Policor
19	Adlije	Seta	Policia e Kosovës	Hetues
20	Teuta	Fejza	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike	Drejtor i QRSH
21	Kumrije	Krasniqi	Policia e Kosovës	Hetues
22	Arsim	Maxhuni	Administrata Tatimore e Kosovës	Inspektor i mesëm tatimor
23	Afërdita	Ahmeti	Administrata Tatimore e Kosovës	Inspektor Tatimor
24	Mevlide	Kosumi Qarri	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	Gjyqtar
25	Florim	Shkreta	Komuna Hani i Elezit	Kryesues i Kuvendit Komunal
26	Mevlyde	Kelmendi Begolli	Kompania Rajonale e Ujësjellësit - Hidrodrini	Anëtar i Bordit në Ndërmarrje Publike
27	Bastri	Zejnullahu	Policia e Kosovës	Komandant i Stacionit Policor
28	Bergita	Curri	Instituti i Mjekësisë Ligjore	Ekspert i Mjekësisë Ligjore
29	Hysri	Ibishi	Dogana e Kosovës	Oficer i Lartë Doganor
30	Labinot	Ibrahimi	Policia e Kosovës	Mbikëqyrës
31	Ferat	Rukolli	Policia e Kosovës	Hetues
32	Enver	Gashi	Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar	Anëtar
33	Anton	Zhushi	Administrata Tatimore e Kosovës	Inspektor i mesëm tatimor
34	Miroslav	Minic	Komuna e Leposaviqit	Drejtor për Bujqësi dhe Zhvillim Rural

35	Osman	Halitaj	Administrata Tatimore e Kosovës	Inspektor Tatimor
36	Shenaj	Bashota	Inspektorati i Arsimit	Inspektor i Arsimit
37	RAMADAN	DACAJ	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	Kryetar i nën këshillit
38	Valbona	Leka	Policia e Kosovës	Hetues
39	Sylë	Kolica	Administrata Tatimore e Kosovës	Inspektor Tatimor
40	Esfere	Sherifi	Inspektorati i Arsimit	Inspektor i Arsimit
41	Ivana	Zivic	Ministria e Shëndetësisë	Inspektor Sanitar
42	Mirjana	Velić	Komuna e Graçanicës	Auditor i Brendshëm
43	Marko	Bogosavljevic	Administrata Tatimore e Kosovës	Zyrtar administrativ për mbledhjen e orxheve
44	Violeta	Sakic	Komuna e Leposaviqit	Drejtoreshë për Mirëqenie Sociale
45	Milenko	Milintijevic	Dogana e Kosovës	Oficer i Lartë Doganor
46	Radiša	Mihajlovic	Policia e Kosovës	Hetues
47	Xhemajl	Dervishi	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës	Koordinator i Zyrës Regjionale ne Titrovice
48	Bekim	Krasniqi	Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës	Zv. Kryesues i Njësisë për Zbatim
49	Nazmi	Hoxha	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	Këshilltar i Jashtëm Politik i Ministrisë
50	Marko	Arsic	Administrata Tatimore e Kosovës	Zyrtar administrativ për mbledhjen e orxheve
51	Aleksandar	Milojević	Administrata Tatimore e Kosovës	Zyrtar administrativ për mbledhjen e orxheve
52	Nemanja	Sekulić	Administrata Tatimore e Kosovës	Inspektor i mesëm tatimor
53	Arlinda	Zahiti	Komuna e Leposaviqit	Drejtoreshë për Komunitete
54	Marigona	Preteni-Peci	Komuna e Leposaviqit	Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik
55	Elianë	Blakaj	Komuna e Istogut	Drejtor i Drejtorisë
56	Arrita	Gola	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	Këshilltar politik
57	Edojeta	Hasanaj	Komuna e Istogut	Zyrtar për Buxhet dhe Financa
58	Abdurrahman	Junuzi	Policia e Kosovës	Istrazni policajac
59	Agron	Dina	Kompania Regjionale e Mbeturinave EKOREGJIONI	Anëtar i Bordit në Ndërmarrje Publike
60	Kaltrinë	Zenuni	Organi Shqyrtues i Prokurimit	Ekspert i Jashtëm Teknik i Prokurimit
61	Aurorë	Osmani-Buca	Komuna e Gjilanit	Anëtar Bordi
62	Halim	Behramaj	Policia e Kosovës	Hetues
63	Valon	Shala	Ministria e Shëndetësisë	Inspektor Sanitar
64	Gentiana	Ahmeti	Administrata Tatimore e Kosovës	Inspektor Tatimor
65	Dalibor	Dobrosavljevic	Administrata Tatimore e Kosovës	Zyrtar administrativ për mbledhjen e orxheve
66	Nazmije	Paqarizi	Spitali i Përgjithshëm në Prizren	Zyrtar i Lartë i Prokurimit
67	Nazmi	Suma	Komuna Hani i Elezit	Anëtar i Bordit në Ndërmarrje Publike
68	Aleksandra	Andjelković	Dogana e Kosovës	Oficer i Lartë Doganor
69	Besnik	Hyseni	Policia e Kosovës	Zyrtar i Lartë Hetues
70	Rrahman	Selmani	Komuna Shtime	Inspektor i Komunikacionit

71	Naim	Nuhiu	Policia e Kosovës	Hetues
72	Ahmet	Delolli	Inspektorati i Punës	Udhëheqës i Divizionit për Koordinim Rajonal-Prishtinë
73	Ymer	Sylejmani	Policia e Kosovës	Hetues
74	Mehmet	Zeqiri	Policia e Kosovës	Hetues
75	Nuhi	Maliqi	Administrata Tatimore e Kosovës	Zyrtar për mbledhjen e borxheve tatimore
76	Rrushe	Gashi	Komuna e Prishtinës	Zyrtare e Prokurimit
77	Feti	Breznica	Komuna e Fushë Kosovës	Inspektor i Ndërtimit
78	Elizabeta	Kabashi	Administrata Tatimore e Kosovës	Zyrtar i mesëm i mbledhjes se etyrueshme
79	Erim	Berisha	Ministria e Zhvillimit Rajonal	Këshilltar i jashtëm politik
80	Zenun	Kqiku	Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit	Inspektor i Auto Shkollave
81	Bislim	Sadriu	Policia e Kosovës	Hetues
82	Jakup	Berisha	Policia e Kosovës	Hetues
83	Erden	Atiq	Komuna e Mitrovicës së Veriut	Kryetar i Komunës
84	Fehmi	Krasniqi	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	Anëtar
85	Agron	Maloku	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	Drejtor i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme
86	Gani	Halilaj	Qendra Klinike Universitare e Kosovës	Ekspert Mjeko Ligjor
87	Beqir	Berisha	Komuna e Suharekës	Inspektor i Ambientit
88	Orhan	Hyseni	Dogana e Kosovës	Oficer i Lartë Doganor
89	Nazife	Rrecaj	Administrata Tatimore e Kosovës	Zyrtar i mesëm i mbledhjes se etyrueshme
90	Esat	Maxhuni	Agjencia Shtetërore e Arkivave	Inspektor i arkivës

Lista e subjekteve deklaruese që nuk kanë respektuar afatin e deklarimit të pasurisë me marrje të detyrës DMD

Nr.	Emiri	Mbiemri	Funksioni	Institucioni
1.	Kujtim	Zajmi	Mjek Specialist i Mjekesise se Punes	Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës në Gjakovë
2.	Rrahman	Shala	Mjek specialist Ortoped	Spitali i Përgjithshëm në Prizren
3.	Lulzim	Ibri	Profesor i asocuar	Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren
4.	Albert	Shkoza	Mjek specialist Neonatolog	Spitali i Përgjithshëm në Ferizaj
5.	Nakije	Baliu	Mjek specialist	Spitali i Përgjithshëm në Gjilan
6.	Gazmend	Musliu	Mjek Specialist Mjekësi Emergjente	Spitali i Përgjithshëm në Mitrovicë
7.	Luan	Kryeziu	Profesor asistent	Universiteti "Hasan Prishtina" Prishtinës
8.	Orhan	Qerimi	Mjek specialist	Shëndeti Mendor i Kosovës